

PROLETARE TE TE GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNI!



LËVIZJA PËR PAVARËSINË E KOSOVËS - LRSSHJ

PUNËTORËT

ORGAN I KK TË BASHKIMIT TË PUNËTORVE TË KOSOVËS



VIJA POLITIKE E KËRKESËS PËR REPUBLIKË

Kërkesa për republikë vetvetiu përcakton vijën e qartë të luftës politike për realizimin e saj. Me fjalë tjera kjo kërkesë është në përputhje të plotë me rendin kushtetutar në RSFJ. Pra, është kërkesë për realizimin e të drejtave ligjitime të klasës punëtore dhe popullit të Kosovës, të cilat garantohen me kushtetutën e RSFJ.

Kjo kërkesë ligjore dhe demokratike e Kosovës nuk është realizuar pas LDB (Luftës së Dytë Botërore) në sajë të qëndrimit kolonialist e hegjemonist të shovinizmit shtetomadh, nga pozitë e më të mëdhenjëve dhe më të fortëve.

Në periudhën mes të viteve 1946-1966 është e njohur se çfarë pozite politike e nacionale pat Kosova. Pas vitit 1966, Kosovës në mënyrë graduale filluan t'i realizohen të drejtat dhe kjo periudhë stagnon në vitin 1980.

Gjat tërë sundimit të Serbisë në Kosovë u bë shtypje e rëndë politike e nacionale dhe shfrytëzim e plaqkitje ekonomike për çka Kosova ngeci ekonomikisht 50% pas mesatares në RSFJ.

Kjo gjendje u bë e padurshme dhe paknaqësia e mbledhur me vite kanosej që të shpërthente si një vullkan. Për shkak të kësaj pozite politike në Kosovë gjithmonë ishte prezente lëvizja e rezistencës. Kjo lëvizje pas viteve 1945 përjetoi një ndarje në 3 rryma politike. Njera nga to iu nënshtrua pozitës skllavëruese dhe u bë vegël e reaksionit serbomadh. Në antagonizëm me këtë rrymë vadhdoi të vepron lëvizja për shpërndarjen e Kosovës nga RSFJ. Dhe, pranë këtyre dy rrymave politike vepron edhe rryma e tretë politike e cila ndryshimin pozitiv të kësaj pozite të vështirë të Kosovës e shihte në përjet të realizimit të të drejtave

kushtetutare që u garantoheshin popujve të RSFJ për pavarësi, barazi dhe individualitet në kuadër të federatës jugosllave.

Rryma e parë politike e cila u bë vegël e reaksionit rankoviqist, miratonte dhe zbatonte politikën antishqiptare e kundër kushtetutare e në kundërshtim me programin e PKJ, duke bërë shkelje të rënda të të drejtave të popullit shqiptar të Kosovës.

Rryma tjetër politike që ishte në kundërshtim të plotë me të parën, çështjen e çlirimit të Kosovës nga ky sundim i egër e shihte përmes shpërndarjes së Kosovës nga RSFJ, kështu që pjestarët e kësaj lëvizjeje ndiqeshin dhe persekutoheshin sipas ligjeve të RSFJ.

Rryma e tretë politike kishte përcaktimin dhe zhvillohej si lëvizje për pavarësinë e Kosovës nga sundimi serbomqedono-malazez, përmes realizimit të të drejtave që u garantoheshin popujve në RSFJ me anën e kushtetutës së RSFJ. Kjo lëvizje ishte plotsisht pajtim juridik e politik në RSFJ; që do të thotë se kërkonte në mënyrë të ligjshme e të hapët realizimin e të drejtave që i takonin Kosovës së tërësishme, gjë që po vazhdonë edhe sot duke potencuar realizimin e të drejtave të Kosovës për themelimin e RS Shqiptare në kuadër të RSFJ.

Siç dihet kërkesa për RSSH të Kosovës nuk mbeti kërkesë e një rryme politike por një kërkesë e përgjithshme e klasës punëtore popullit shqiptar në Jugosllavi e cilanë sajë të rezistencës së reaksionit shovinist për të penguar realizimin e kësaj kërkesë kjo rrymë u shëndërrua në lëvizje të përgjithshme popullore, e cila (LRSSHJ) po zhvillon luftë politike të sukseshme vite me radhë.

Lëvizja për pavarësinë (republikën) e Kosovës gradualisht fitoi pjekurin e vet organizative që në vitet 1967-1968 t'ia arrin të organizojë kërkesat për realizimin e të drejtave demokratike në mesin e të cilave shquhej edhe kërkesa për republikë.

Pas këtyre demonstratave u realizuan gadi të gjitha kërkesat pos kërkesës për republikë, të cilës në atë kohë udhëheqësia e LKJ dhe RSFJ iu përgjegj që "akoma nuk janë pjekur kushtet". Pas vitit 1966 u thellua demokratizimi i marrëdhënjëve shoqërore në Jugosllavi dhe ky orientim qonte kah realizimi i barazisë.

Në vitin 1974 Kosova e tërësishme e ciptuar e nën sundimin e Serbisë, Malit të Zi e maqedonisë morri një shkasë për shpresë se do t'i realizohet edhe e drejta në pavarësi, individualitet e barazi të plotë në RSSH të Kosovës, me anën e amandamenteve që u propozuan më parë. Mirëpo shpresat nuk u përmbushën, sepse në vend të republikës, çështja e Kosovës u "zgjodh" ndryshevetëm Kosova qendrore fitojë autonomi, por prap nën sundimin e Serbisë.

Lëvizja për pavarësinë (republikën) e Kosovës, qysh atëherë ndjeu se demokratizimi i marrëdhënjëve shoqërore po fillon të stagnon dhe u panë tentativat e rikthimit të regjimit rankoviqian të para vitit 1966. Për këto shkaqe u pa e arsyshme që kjo lëvizje të merr format e organizuara të nivelit më të lartë, ngase shpresat që çështja e Kosovës do të zgjidhet nga vet udhëheqësia e LKJ dhe e RSFJ kishin filluar të shuheshin.

Për këto arsye në vitin 1975 bijtë e denjë të klasës puntore dhe të popullit të Kosovës i hynë themelimit të Partisë (PKMLSHJ) Komuniste

↓ të Kosovës e cila do të organizonte kërkesën për RSSH të Kosovës në mënyrë ligjore, demokratike e revolucionare.

Partia veprimi në organizimin e kërkesës për republikë, duke u orientuar në dy kahje kryesore ; Në organizimin dhe në mobilizimin e masave dhe në organizimin e kërkesës për republikë në mënyrë zyrtare para udhëheqësisë së LKJ e RSFJ që ata vet ta realizojnë këtë të drejtë.

Pasi që Partia shtroi hap-tazi platformën e kërkesës për republikë para udhëheqësive të LKJ e RSFJ (platformë-kjo që është në realizime sipër edhe sot) në të cilën nuk u dha as përgjegjëje pozitive e as negative, në të gjitha memorandumet që mes viteve 1975-1980 i paraqiti me kërkesën e klasës punëtore dhe popullit të Kosovës, veprimi për organizimin e kësaj kërkesë në mënyrë demonstrative.

Në vitin 1981 kërkesa për republikë u shtrua në mënyrë publike dhe demonstrative. Përgjegjëja erdhi tradhtisht poshtu sikurse tradhtisht u fut Kosova nën sundimin e Serbisë-Malit të Zi-Maqedonisë.

Në vend që t'i realizohej kjo kërkesë, Kosova përjetoj një agresion të armatosur nga ana e hordhive dhe bandave të kriminelëve me uniforma të ushtrisë dhe milicisë Jugosllave që edhe para vitit 1966 ishin pikmbështetja kryesore e rankoviqistit.

Ky agresion i armatosur që iu bë Kosovës ishte një grushtet i mirfilltë i serbomdhënjëve për të rikthyer regjimin e para 1966-ës.

Përgjegjëja në kërkesën për republikë as kësaj radhe nuk erdhi nga LKJ e RSFJ por erdhi nga fraksioni rankoviqist të cilit ia njohim mendimet për Kosovën dhe nga i cili as nuk presim as nuk kërkojmë përgjegjëje.

Kjo do të thotë se pavarësisht ç'thonë rankoviqistët, lufta për republikë mbetet në fuqi dhe ajo vazhdon deri në realizim, por jo sipas diktatit rankoviqist dhe të veglave të tij.

NJOFTIM

SHOKË PUNËTORË

Ju njoftojmë se organi "PUNETORET" është organ i jonë i klasës punëtore të Kosovës.

"PUNETORET" është gazetë informative, politike, propagandistike dhe programoro-aksionale e cila delë kohë pas kohe. Me dokumentet e bashkimit të 17 Shkurtit 1982 u muar vendimi që LRSSHJ të organizohet në organizatat e brendshme dhe si rezultat i punës që u bë për të realizuar këto vendime të rëndësishme historike u themelua ORGANIZATA SINDIKALE E BASHKIMIT TE PUNETORVE TE KOSOVES si repartë pararojë e klasës punëtore të Kosovës së tërësishme, me çka dëshmohet vetëdija e klasës punëtore dhe vendosmërija për zbatimin konsekuent të vendimeve të 17 Shkurtit 1982. Me këtë dokument të bashkimit u rregullua edhe çështja e emërimit të organeve të organizatave të brendshme të LRSSHJ, nga ana e vet këtyre organizatave.

Redaksia e "PUNETORVE" boton dokumente të BPK, bënë informimin politik dhe propagandistik të luftës dhe të kërkesave të klasës punëtore të Kosovës në kuadër të LRSSHJ, dhe, botonë programet aksionale të KK të BPK, në bazë të të cilave ç' do punëtorë dhe ç' do organizatë bazë e BPK, si të atyre të mvarura ashtu edhe ato të pamvarura, nxjerrin detyrat konkrete të cilat duhet realizuar në kuadër të luftës politike si dhe kahjet e vijën e cila është e përcaktuar me dokumentet e BPK, me programin e PKK që është prijëse ideore dhe me platformen e LRSSHJ që është udhëheqëse e Lëvizjes për Pavarësinë (Republikën) e Kosovës.

Gjithashtu për redaksinë e organit "PUNETORET" është me rëndësi, që të gjithë punëtorët kosovar; pa marr parasysh se a janë të inkuadruar apo të pa punësuar, pa dallim moshe, gjinije, pa dallim të niveleve arsimore, pa marr parasysh se a punojnë jashtë Kosovës nëpër vendet tjera të Jugosllavisë apo në botën e jashtme dhe pa marr parasysh se në cilën pjesë të Kosovës jetojnë (Kosova-përfshinë të gjitha krahinat shqiptare në Jugosllavi) të gjithë këta të bashkpunojnë me redaksinë e organit "PUNETORET" me anën e korospondencës (letrave), në të cilat mund të shtrojnë pyetje, të japin informata, të bëjnë propozime, të shkruajnë artikuj dhe të bëjnë vrejtitet e veta.

Është e njohur se "PUNETORET" nuk është gazetë me mundësi legale e as me bazë materiale të mjaftueshme që kjo gazetë të shtypet në numër (tirazh) të mjaftueshëm, andaj lexuesit që kanë mundësi, ta shumëzojnë dhe ta shpërndajnë më tutje, numrin që u bie në dorë. Shumëzimi mund të bëhet me shtypje, me fotokopjim dhe me ingjizime magnetofonike. Ata që këto mundësi nuk i kanë, "PUNETORET" duhet ta propagandoi duke përcjellë numrin nga dora në dorë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo në mënyrë anonime.

R E D A K S I A

...
Vija e luftës politike për realizimin e kërkesës për republikë nuk ka ndryshuar, ajo mbetet në fuqi. Kjo vijë politike është e qartë. Ajo është

në pajtim me programin e LKJ, me kushtetutën e RSFJ dhe as kund nuk bje në kundërshtimë me rregullimin e brendshëm federativ të RSFJ.





TRI PARIMET KRYESORE TË VIJËS POLITIKE

I
- Pjestarët e Lëvizjes për Republikën e Kosovës (LRSSHJ) duhet ta kuptojnë qartë se kërkesa për republikë është revolucionare dhe realizimi i saj është i domosdoshëm, andaj të gjithë ata që luftojnë për realizimin e kësaj kërkesë duhet të respektojnë vetë dhe të kërkojnë nga të tjerët realizimin e normave të përcaktuara me aktet ligjore të Jugosllavisë (atyre pozitive).

Ç' do kushqë vjen në kundërshtim me anët pozitive të kushtetutës dhe rendit juridik në përgjithsi të RSFJ, Lëvizja dhe formacionet e saja, janë të distancuara dhe ç' do veprim i tillë në emër të LRSSHJ apo organeve të saja, është i denueshëm.

Duhet të jetë gjithashtu e qartë se burgosjet, masakrimet, shtypjen e padrejtësit që po i ndërmarrin forcat reaksionare rankoviqiste duke përdorur terrorin shtetëror kundër bijëve të Kosovës, të cilët shprehën haptazi kërkesën për republikë, janë veprime e krime në kundërshtim me rendin juridik e kushtetutar të RSFJ.

Shovinizmi serbomadh rankoviqian dhe reaksioni separatist maqedon e reaksioni minimalazezomadh për këto vepra, dhe, për tëra pasojat që i shkaktuan popullit shqiptar të Kosovës gjatë sundimit të tyre do të japin përgjegjësi para historisë, kurse Lëvizja do t'i lufton me të gjitha mjetet e mundshme.

Pra, konkluzioni delë se LRSSHJ e në kuadër të saj edhe BPK do të zhvilloi luftë politike këmbngulëse për realizimin e kësaj kërkesë duke përdorur të gjitha mjetet demokratike, revolucionare e kushtetutare pa i cënuar rregullat normative të RSFJ, unitetin e barazisë si dhe bashkjetesën me popujt tjerë në kuadër të RSFJ.

II

- Lëvizja për pavarësinë e Kosovës (LRSSHJ) do t'i kupton drejtë ata persona, të cilët vazhdojnë të qëndrojnë në lëvizjen për shkëputjen e Kosovës nga RSFJ dhe për bashkimin e saj me tringun kombëtar, nëse ata nuk pajtohen me këtë kërkesë, nëse ata nuk e sulmojnë as nuk e përkrahin, këtë kërkesë dhe nëse nuk e sulmojnë rendin e Shqipërisë së sotme (RPSSH), që qëndrojnë dhe jashtë LRSSHJ e kusekuent në vijën e vet politike me qëndrime revolucionare. Ndaj tyre LRSSHJ do të mbajë qëndrim parimor dhe nga ta do të kërkon qëndrim të njejtë-neutral e në distancë të caktuar pa u përzier në punët e njeri tjetrit.

III

- Ata persona apo grupe që qëndrojnë brenda apo jashtë tyre dy rrymave; që sulmojnë kërkesën për republikë apo, kërkesën për republikë e ngatërojnë me shkëputjen e Kosovës nga RSFJ nuk janë pozita revolucionare, por provokatore e vegla të huaja, pseudopatriot e armiq edhe të Kosovës edhe të Shqipërisë, andaj nga ata LRSSHJ distancohet e i konsideron reaksionar i dënon dhe i lufton si armiq të klasës punëtore dhe popullit nëse këtë e bëjnë me vetëdije.

Arsyeja për egzistimin e këtij parimi të vijës politike është se kërkesa për republikë është e ligjshme dhe nuk cënon sovranitetin dhe integritetin teritorial të RSFJ. Në anën tjetër RPS e Shqipërisë e mbështetë këtë kërkesë e ka qëndrim parimor ndaj Kosovës, dhe nga RSFJ kërkon atë që i lejohet me normat ndërkombëtare, të cilat Jugosllavija duhet t'i respekton, t'i zbaton dhe t'i realizon të drejtat që i takojnë Kosovës, pa u përzier në punët e brendshme të RSFJ. Andaj, përzierja e këtyre dy vijave politike kompromiton edhe me këtë rast edhe Kosovën edhe Shqipërinë. Pra, ç' do njeri duhet të përcaktohet ose në kërkesë

për republikë ose në kërkesën e shkëputjes së Kosovës nga RSFJ, kurse ç' do ngatërrim i këtyre dy vijave politike në etapën e sotme është reaksionare.

MARRËDHËNJET E LRSSHJ ME SHTE-TET, PARTIT E LËVIZJET TJERA

LRSSHJ është plotësisht e pavarur politikisht nga ç' do faktor i jashtëm dhe përgjigjet vetëm para klasës punëtore dhe popullit të Kosovës. Qëndrimi i LRSSHJ ndaj faktorëve të jashtëm, në marrëdhënjet me shtetet, partit dhe lëvizjet jashtë Kosovës është plotësisht parimorë dhe i pamvarur duke përfshirë këtu edhe LKJ e RSFJ dhe PPSH e RPSSH, duke respektuar me ç' do palë tjetër principet e barazisë, pammvarsisë dhe mos përzierjen në veçoritë vetiake.

Kosova gjendet brenda kufijve të RSFJ dhe me forcat progresive në RSFJ do të zhvillojë marrëdhënje normale, kurse sa i përket Shqipërisë marrëdhënjet politike e ekonomike me të do t'i zhvilloi në suaza të marrëdhënjeve kontraktuese në mes të RSFJ dhe të RPSSH.

Në aspektin kombëtar Kosova do të orvatet që të zhvillojë marrëdhënje kulturore-arsimore që është nevojë e përbashkët, ndërsa mbrojtja e tërsishme kombëtare nga ndonjë agresion eventual, nga çdo fuqi e jashtme që e sulmon cilëndo pëllëmbë të tokës shqiptare, si në Kosovë ashtu edhe në Shqipëri, mbrojtja do të jetë e përbashkët.

Ndalohet vuarja e zhvillimi i marrëdhënjeve të anëtarëve të LRSSHJ e të formacioneve të saja të brendshme, jashtë organeve kompetente e të autorizuara, me shtetet, partit e lëvizjet e vendeve tjera.

LRSSHJ, politikisht dhe moralisht, është plotësisht e pavarur dhe nuk pranon diktatin e askujt nga jashtë.

Para së gjithash klasa punëtore është repartë pararojë e shoqërisë në tërësi dhe në ç' do vend është pararojë e kombit që i përket.

Armët që i posedon klasa punëtore në shoqëri janë qën-sore, sepse, i tërë prodhimi material dhe të tëra fijet e jetës shoqërore janë në duar të klasës punëtore. Me këtë ipet të kuptohet se që nga ushqimi i përditshëm e deri tek metalurgjia e energjetika vijnë nga duart e djersa e klasës punëtore.

Këto njëherit janë kushtet pa të cilat një shoqëri nuk mund të egzistojë. Pra, s'ka armë politike më të fortë se prodhimi dhe funksionimi i tij në shoqëri. Kjo armë në luftën klasore mund të gjunjëzojë para klasës punëtore ç' do lloj borgjezije, sepse edhe aparati shtetëror i dhunës, ushtria dhe policia e borgjezisë nuk mund të funksionojë pa djersën e punëtorve. Atëherë, pse klasa punëtore vështirë po ia arrinë që të korrë fitore në luftën klasore me borgjezinë?

Përgjegjëja më reale është mungesa e një rezistence të organizuar të punëterve të bashkuar.

Atëherë, kujt i bie detyra që t'i bashkon punëtorët dhe që t'i organizon ata?

Është mendim i huaj dhe thellësisht i gabuar, ai, që klasa punëtore duhet të pretë që ta organizojë inteligjenca apo ndonjë kast tjetër shoqërore. Klasa punëtore duhet të nxjerrë nga gjiiri i vet organizatorët.

Kushtet për këtë, klasa punëtore i ka, sepse me krijimin e saj u krijua vetëdija klasore, nga e cila lindi ideologjia klasore. Kështu erdhi deri tek themelimi i partive të klasës punëtore.

Partia duhet të apsorbojë të gjithë elementët më të mirë të klasës punëtore, eksperiencën e tyre, shpirtin e tyre revolucionar, besnikrin e tyre të pakufishme ndaj kauzes së proletariatit. Nga këtu në partin e klasës punëtore, gjithmonë përfshihen edhe bijtë

KLASA PUNËTORE REPARTË PARAROJË E SHOQËRISË

e saj nga inteligjenca popullore, ku bashkohen praktika dhe teoria revolucionare në nivelin më lartë të organizimit.



Në barikadat e luftës klasore

Inteligjenca popullore gjithmonë është në shërbim të klasës punëtore dhe sa herë që kemi paraqitje të kundërta kemi të bëjmë me inteligjencë të borgjezuar. Por, që partia të jetë me të vërtetë një repart pararojë, ajo duhet të jetë armatosur në teorinë revolucionare, duhet të njejë ligjet e lëvizjes së shoqërisë dhe ligjet e revolucionit. Pa këtë ajo nuk është në gjendje të udhëheqë luftën e proletariatit dhe të tërheqë atë pas veti. Kjo nuk vlenë vetëm për partin por, kjo vazhdon edhe për ç' do pjestarë të klasës punëtore. Ç' do punëtorë duhet të përcjellë me vëmendje shtypin revolucionar dhe të merrë pjesë aktive në analizimin politik dhe të shtron mendimet e veta.

Pra, punëtori nuk duhet të pret të mësoi vetëm nga agjitacioni verbal, por edhe duhet të nxjerrë detyrat nga programet revolucionare dhe të merrë orientimet aksionale nga shtypi revolucionar. Ka momente kur punëtori duhet të veproi edhe atëherë kure shën të arsyeshme pa pritur që të merrë nga të tjerët direktiva dhe kjo zbatohet kryesisht në kolektivët punuese. Punëtori ka për detyrë që të vigjilojë edhe mbi armikun, shtypin e tij reaksionar dhe me vetiniciativë të ndërmerre kundër-aksione.

Duhet kuptuar se ç'ështëja e e çlirimit klasor dhe pavarësisë nacionale mvaret nga çdo njeri e nga ç' do punëtorë.

Partia nuk mund të funksionojë pa klasën punëtore, por as klasa punëtore nuk mund të funksionojë e të organizohet në një front pa partin e vet. Nga përvoja historike e Kosovës kemi një shembull konkret;

Në Jugosllavi pas vitit 1945, ato vende që kishin partitë e veta të pavarura në kuadër të PKJ, ia arritën që të krijojnë republikat e vet nacionale, kurse vetëm Kosova e cila nuk pat parti të pavarur mbeti; politikisht, ekonomikisht dhe në ç' do aspekt tjetër nën sundimin e të tjerëve.

Porsa në Kosovë erdhi deri te themelimi dhe veprimi aktiv i partisë pas vitit 1975 erdhi deri te zhvillimi i një lufte të suksesëshme politike për pavarësinë e për krijimin e republikës së Kosovës, dhe në këtë mënyrë armiku u godit dhe po dobësohet vazhdimisht, kurse partia duke fituar besim-

in e masave u shëndrrua në një lëvizje të përgjithshme popullore ku u përfshinë të gjitha forcat revolucionare të klasës punëtore, të inteligjencës dhe të popullit të Kosovës.

Ç'do lëvizje dhe ç'do parti nuk mund të jetë parti e vërtetë nëse nuk është në shpirtin dhe trupin e masave që të ndijë dëshirën e tyre momentale, që të veproi në këto kushte për të krijuar mundësi e kushte për etapën e ardhshme, sepse shkallëzimi është nevojë dialektike.

Sa herë që të provohet që të kalohen dhjetë shkallë me një hapë rëximi është i domoshëm, kështuqë në vend se të shkohet para bëhet marshim i damshëm e regresiv, pasi që ngecet në vend. Këte e ka vërtetua e po e vërteteton praktika.

... NË HAP ME SHPIRTIN E MASAVE

Ç'do lëvizje e ç'do parti, nuk është parti e vërtetë; në qoftëse kufizohet në organizimin e vetvetes, në qoftëse kufizohet në regjistrimin e asaj që ndien dhe mendon populli dhe klasa punëtore, në qoftëse zvarritet në bisht të lëvizjes spontane, në qoftëse nuk di të tejkalojë plogshitinë dhe indiferencën e lëvizjes spontane, në qoftëse nuk di të ngrihet përmbi interesat e qastit të proletariatit, në qoftëse nuk di t'i ngrit masat në nivelin e kuptimit të interesave reale-momentale që shërben për trasimin e rrugës drejtë interesave kurrizore të klasës punëtore dhe të popullit. Lëvizja apo partia duhet të jetë në ballë të klasës punëtore që t'i ndriqojë e kjartsojë rrugët e luftës, duhet të shohi më larg se masat, ajo duhet t'i prinë frontit e të qanë ate e jo të zvarritet në bisht të lëvizjes spontane dhe në mënyrë artificiale t'i mvesh vetes ndonjë meritë të këtij spontaniteti apo edhe meritat e një force tjetër, sepse me këte rrehet e mashtro-

het vetvehtja. Ngase, kjo i tejkalon caqet revolucionare e bëhet përques i rëndomtë i politikës fallso-borgjeze e reaksionare e cila e dehtë vetvehten. Lëvizja apo partia, mbështetet në të vërtetën e vet, sepse ç'do shkelje në të pavërteta siguron vetëm fundosje të shpejta.

ÇËSHTJA E ÇLIRIMIT KLASOR VARET NGA Ç DO PUNËTORË

Për t'ju përmbajtur rrugës së vërtetë ç'do lëvizje dhe ç'do parti duhet të përgjojë zërin e masave dhe të ecë me shpirtin e tyre, andaj kontakti me masat është kontakt me realitetin dhe kjo të ndihmon që të parashihësh hapin e ardhshëm, të shohësh më larg, të planifikosh më herët të ardhmën. Lëvizja, Partia dhe bashkimi i punëtorve, duhet për këto arsye të jetë në kontakt me masat e me punëtorët dhe ta ndigjoj zërin e fjalëve të tyre. Kjo iniciativë duhet të vijë lirisht e sa herë që e do nevoja edhe nga vet njerzite të gjitha kastave shoqërore të popullit dhe nga ç'do punëtor veç e veç. Pra, ç'do punëtor duhet të kuptojë se ç'është e çlirimit klasor e kombëtar të sundimit të huaj mvaret edhe nga vet ai, dhe se nga kontributi i tij do të mvaret fati dhe e ardhmja e tij, pasi që ç'do njeri ndan fatin me popullin që i takon.

Në rrugën e revolucionit e gjatë saj ka patur e do të ket konfrontime me provokatorët e tradhëtar me motive të ndryshme; personale e politike por lufta ndaj tyre është në kontekst të luftës ndaj armiqëve klasor. Pa marrë parasysh pas ç'far fasade fshihen sot apo neser ata janë dorë e zgjatur e armikut. Andaj, as kjo nuk duhet të na tronditë. Lufta jon po korrë fitore dhe ajo do të jetë edhe më e sukseshme me kuptimin nga ana e secilit punëtor për rolin vetjak (Individual) që i takon në këtë front.

KËRKESË E ETAPËS SË SOTME HISTORIKE REPUBLIKA

Lufta është vepër e masave të gjëra popullore e atyre që marrin pjesë në te dhe medo mos, për shkak situatave eventuale konfuze, ndonjëherë për shkak të papjekurisë politike të atyre që udhëheqin këtë luftë, në kushte dhe rrethana të caktuara, mund të lindin, nëse ato veç nuk janë të montuara, konfuzione ideologjike të cilat dëmtojnë luftën duke përçarë masat në grupe e parti të ndryshme.

Se shqiptarët kanë qenë të

bashkuar gjithmonë kur ka qenë në pyetje çështja e atdheut, historia flet për të gjitha periudhat e luftës heroike të popullit shqiptar. Një dëshmi e freskët janë demonstratat e pranverës së vitit 1981 e pastaj edhe bashkimi i tri rrymave politike në IRSSHJ, me çka vërehet një vetëdije e lartë e masave, megjithëse as tani nuk është përjashtuar mundësia që njerëz të ndryshëm, për shkak të konceptioneve të gabuara, duke mos i njohur ligjet e përgjithshme të revolucionit e ndoshta edhe drejtpërsëdrejti armiku të munda het të përqaqë masat e të mbjellë konfuzione ideologjike, duke sulmuar kërkesën për republikë, si një kërkesë "jo e drejtë" e "jo revolucionare".

Në fakt kërkesa për republikë, jo vetëm që është një kërkesë e drejtë dhe revolucionare, por ajo qëndronë edhe mbi baza marksiste-leniniste,

dhe kësaj askush s'mund t'i bëjë bisht. Pikërisht duke enjohur këtë realitet të pamohueshëm armiku këtë kërkesë e ka sulmuar më së shumti dhe kur vërejtja se me sulm të drejt - përdrejtë nuk po mund t'i largojë masat nga kjo kërkesë, i futi në përdorim agjenturat e tija me qëllim që t'i largojë masat nga kjo kërkesë duke propaganduar vija e rrugë të ndryshme, gjë që do të reflektonte në thyerjen e unitetit. Armiku filloi të propagandojë në masa se gjëja kërkesa për republikë nuk është aspak revolucionare për arsye se shteti jugosllav na qenka një shtet revizionist dhe ç'do tu duhej shqiptarëve të Kosovës-republika në një shtet revizionist, pastaj se gjëja nuk qenka e mirë edhe për Shqipërinë Socialiste dhe u shkuaq larg sa u tha se kjo është kërkesë e përgaditur në Beograd nga vet shovinistët serbomdh-enjë!

Populli është barometër që më së miri i vlerëson momentet dhe situatat, ai sot kërkon republikë i bindur se ka mundësi që ta realizon këtë aspiratë, që është përparimtare e revolucionare.

Populli i Kosovës së tërsishme dëshirën e tij e shprehur në dhjetor të dyzetetreshes në Bujan, por kjo nuk u realizua pas Luftës së Dytë Botërore, ngase Kosovës së tërsishme iu mohuan të gjitha të drejtat dhe premtimet që iu dhanë gjatë LNÇ. Me luftë të vazhdueshme politike dhe me përkrahjen e forcave progresive në RSFJ, ia arriti që të siguroi, për Kosovën e ngushtë (është fjala për KSA të Kosovës pa krahinat shqiptare nën Maqedoni dhe Mal të Zi), statusin e krahinës autonome.

Sot populli shqiptar i Kosovës së tërsishme kërkoi statusin e RSSH të Kosovës, me çka do t'i realizonte të drejtat në barazi, që kushtetuta ua njehej popujve të tjerë në RSFJ e që popullit tonë i mohohet. Dhe, ne si pararojë jemi të obligueshëm të mos dalim jashtë kërkesave të popu-

llit, ngase atëherë nuk përfaqësojmë popullin, nuk jemi pararojë e tij. Populli kërkoi republikë brenda federatës jugosllave dhe ne do t'i prirjmë në këtë rrugë duke i përdorur të gjitha mjetet dhe metodat për të realizuar një aspiratë të tillë të popullit tonë. Përderisa kërkohet republikë brenda federatës jugosllave do të kërkohet edhe realizimin e të gjitha atyre të drejtave që i kanë të realizuara popujt tjerë brenda

federatës jugosllave dhe pas kësaj do të përmbushim të gjitha obligimet, si popujt tjerë, ndaj federatës.

Populli është zot i fateve të veta, ç'do kërkesë që parashtrori vetes deri më tani e realizoi. Ai i parashtrori vëhtes kërkesën për republikë e din që mund ta realizonë, andaj dhe: KERKESA PËR REPUBLIKE ESHTË E DREJTE, REVOLUCIONARE DHE REALIZIMI I SAJ ESHTË I DOMOSDOSHEM.

DHUNA USHTARAKE E POLICORE-FAKTOR QË INICION SHPËRNGULJET

Për t'u shpërngulur një popull nga një vend në vendin tjetër duhet të ekzistojë një presion i tmerrshëm nga një fuqi e cila posedon aparatat e dhunës të cilës populli s'ka mjete për t'iu kundërvye.

Iniciatorët e shpërnguljeve me presion të forcës së lartë natyrore janë: zjarret, epidemit, vërshimet, tërmetet, tharësit, vullkanet etj. Këto shpërngulje nuk vijnë nga faktori njeri dhe populli i merr si diçka krejt normale.

Janë abnormale dhe jo njerëzore kur në shpërngulje të një populli ndikon faktori njeri. Në raste kur epidemin, zjarrin, vërshimet i bënë dora e njeriut, këto nuk do të jenë faktorë që ndikojnë për shpërngulje të përgjithshme të një populli nga një vend, por të disa individëve apo familjeve, dhe këto janë raste kriminele, për çka përgjegjësia e mban vepërkryesi, simbas normave juridike. Nëse këto lloj shpërngulje i inicon dhuna shtetërore atëherë kemi presion me terror shtetërorë për shpërngulje të një populli prej një vendi në vend tjetër.

Pra, shpërngulja masovike me presion nuk mund të vjen nga individët privat nëse ata ndiqen juridikisht dhe as që për këtë mund të mban përgjegjësi populli nga i cili këta individ marrin përkatësin nacionale.

Një popull mund të marrë përgjegjësin për damet që i shkakton regjimi shtetëror që i përket këtij populli dhe se është i përbër nga pjestarët e këtij populli, si dhe i përkrahur nga vet ai popull.

Shteti mund të organizojë presion me terror shtetëror, për t'u shpërngulur një popull nga vendi në vend, në dy mënyra kryesore, të cilat rraste më të shpeshta konsistohen në mes veti. Pra, kemi shpërngulje me presione ekonomike, të cilat në mënyrë sistematike i organizon regjimi shtetëror ndaj një populli për t'ia bërë jetëshën e pamundur për ta detyruar në shpërngulje në vende të tjera. Masat e presionit ekonomik ndaj një populli janë; plaqkitja e pasurisë individuale dhe shoqërore nga ana e regjimit shtetëror, moslejimi i zhvillimit

ekonomik, pamundësia e inkuedrimit në punë e banorëve, mosfurnizimi me artikuj jetsor, mungesa e objekteve ekonomike mungesa e komunikacionit, mungesa e spitaleve etj.

Shpërngulje me presion politik sjell; keqtrajtimin kulturor, arsimor e shoqërorë, mosbarazia e moslejimi i pavarsisë nacionale, politike-ekonomike e territoriale, sundim i huaj, terrorizimi politik i popullsisë me mohimin e të drejtave nacionale e njerëzore, burgosjet politike në kundërshtim me të drejtat demokratike të njeriut, terrorizimi i popullsisë me forcën e dhunës të ushtrisë e policisë, vrasje masovike (Genocidi), agresioni ushtarak ndaj një populli etj.

Rrethanat vështirësuese dhe rënduese të presionit me terror shtetëror për shpërngulje të një populli nga trojet e veta etnike për në vende tjera sa për të siguruar egzistencën janë sidomos kur shtetishkel të drejtat të cilat ia siguron këtyre popujve me kushtetutën e vet, duke shkelur kushtetutën e vet shteti bënë vepra të rënda për të cilat i duhet të japi përgjegjësi para gjyqjeve ndërkombëtare.

Eshtë e njohur se shtetet agresioniste të traktatit nazofashist që qenë iniciatorët e luftës së dytë botërore, pas përfundimit të kësaj lufte protagonistët kryesorë nazofashistë u përgjigjën para gjyqjeve ndërkombëtare. Këta kriminel lufte dhanë përgjegjësinë e merituar, kurse popujt e këtyre vendeve që për-krahën këtë agresion, opinjoni ndërkombëtar i ndërmorri masat e drejta përkatëse ndaj tyre dhe i detyroi që të paguajn damshpërblimet për damet që u shkaktuan popujve e sulmuar nga ky traktat.

Pra, edhe çdo popull, regjimi shtetëror i të cilit bënë shtypje apo agresion ndaj një populli tjetër, duhet ta dijë se mban përgjegjësi për veprat kriminele të shtetit të vet ndaj popujve të tjerë, andaj duhet që të kundërshtoj me këmbëngulje këto veprime, t'i

bojkotoj dhe t'i denoi ato publikisht.

Në rastin konkret të Kosovës e cila qëndron nën sundimin e Serbisë që nga viti 1913, regjimi i së cilës bëri veprat e lartpërmendura të terrorit shtetëror si presion për shpërnguljen e popullit shqiptar nga trojet e veta etnike në Kosovë të tërsishme dhe veprimtaria tjetër e keqtrajtimin ekonomik e politik dhe të shtypjes e shfrytëzimit plaqkitës, i cili u bë në këto 70 vite në mes të 1913-1983, në kontekst të kolonizimit të Kosovës nga Serbia e cila Kosovën për ta sunduar më lehtë edhe e coptoi në katër pjesë; dhe tri pjesë nga ata i futi nën sundimin direkt të Maqedonisë (krahina jugperendimore e Kosovës), nën sundimin e Malit të Zi (krahina veriperendimore e Kosovës), kurse Kosova Qendrore u shëndrrua në krahinë autonome nën sundimin e Serbisë (KSA e Kosovës dhe viset tjera shqiptare nën Serbi).

Populli serb e tani edhe populli maqedon e malazet duhet ta dijë se për veprat kriminele; politike e ekonomike të regjimit serb, maqedon dhe malazet, mbajnë përgjegjësinë nëse publikisht nuk dalin kundër këtyre veprave e në ndihmë popullit shqiptar të Kosovës, sepse herdokurdo Kosovës duhet t'i përgjigjet dhe t'i ipet damshpërblimi për këto vepra të terrorit shtetëror për këto 70 vite nën sundimin e tyre. Drejtësia do ta kërkon këtë nga populli serb, maqedon e malazet dhe edhe nga popujt tjerë të Jugosllavisë që e lejuan dhe po e lejojnë këtë shtypje dhe këtë shfrytëzim plaqkitës, pasi që edhe ata janë duke bashkjetuar në RSFJ dhe kanë mundësi që të mos e lejojnë këtë e sidomos qarqet qeveritare të këtyre popujve dhe forcat progresive të RSFJ.

Dihet se nga Kosova e tërsishme u shpërngulën gjysma e popullsisë shqiptare në Turqi dhe vende të tjera të Evropës e botës në tri etapa historike kur terrori i madh shtetëror bëri presion për shpërng-

ulje. Kjo sidomos u bë mes të viteve 1913-1945, në mes të 1946-1966 dhe tani pas vitit 1981.

Eshtë e quditshme se si regjimi i sotëm rankoviqist i Serbisë po e akuzon popullin shqiptar të Kosovës se gjëja po bëka presion në serb e malazet për t'u shpërngulur, gjë që është absurde aq sa "ligji i bandës rankoviqiste" i cili shpiku "veprën penale se gjëja kërkesa për republikën e Kosovës po e cënoka barazinë" kur kjo kërkesë është pikërisht për realizimin e barazisë!

Nëse presioni për shpërngulje bëhet me presion ekonomik, me presion politik dhe me terror shtetëror, atëherë a ja në serbët e malazetët nën sundimin e Kosovës apo anasjelltas? A është armata, policia, gjyqjet, burgjet, qeverija serbe, malazeze, maqedone apo kosovare. A po vriten, sakatohen, persekutohen, terrorizohen, burgosen e denohen nga regjimi serbomadh rankoviqist minimalazetomadh e raksionarë seperatistë maqedonomëdhënjë, shqiptarët e Kosovës apo anasjelltas.

Regjimi rankoviqist po e frynë në mënyrë artificiale e falcifikuese problemin e shpërnguljes së serbve dhe malazetve nga Kosova duke u orvatur që për këtë përgjegjësinë t'ua vejë shqiptarve, por të dhanat zyrtare po flasin për pozitën e privilegjuar të serbve, malazetve dhe maqedonasve në Kosovën e tërsishme në çdo aspekt; që nga standarti jetsor, ndarja e banesave dhe inkuedrimi etj., në krahasim me vendasit shqiptar. Megjithatë, serbet e malazetët po shpërngulen nga Kosova. Ata po shpërngulen për dy arsye; një pse në Serbi dhe vende të tjera jasht Kosovës po siguron jetes edhe më të mirë që do të thotë se edhe pse janë të privilegjuar në Kosovë ata nuk janë të knaqur me këtë jetesë e cila në Kosovë është e standartit më të ulët në Evropë; dhe dy, pse pikërisht terrori shtetëror rankoviqistë ndaj shqiptarve po ua bënë je-



ftën e pasigurt në Kosovë, sepse po frigohej mos populli i Kosovës po shpërthen në revoltë për shkak të këtij terori dhe mos po pësojnë diçka ata.

Megjithatë, ne, populli shqiptar, klasa punëtore dhe pararoja e jonë u kemi bërë thirrje dhe prap po u bëjmë thirrje serbve dhe malazezve që të mos shpërngulen nga Kosova sepse ata jo veç që kurrë nuk u rrezikuan as që do të rrezikohen nga shqiptarët as një serb e malazez që nuk i ka hy në hak dhe që s'ka bërë krime ndaj popullit shqiptar.

Ne u themi serbve dhe malazezve që të qëndrojnë në Ko-

sovë dhe bashkarisht të luftojnë për realizimin e të drejtave kushtetuese në barazi e pavarësi të plotë në republikën e Kosovës, sepse barazija dhe pavarësia e forcon unitetin, bashkjetesën dhe mirënjën për të gjithë popujt në Jugosllavin federative.

Eshtë demagogji e armikut rankoviqist se Kosova kërkon etnicitet të pastërt, Kosova, nuk kërkoi që në republikën e saj të përfshihen as të gjitha trojet etnike shqiptare që gjenden në Jugosllavi, por vetëm ato krahina ku popullsia shqiptare është në shumicë.

Këtë të drejtë e gëzojnë të

gjithë popujt tjerë në RSFJ dhe pse të mos i realizohet kjo e drejtë edhe popullit shqiptar, atë herë dihet se kemi të bëjmë me një reaksion racist.

Populli serb, maqedon dhe malazez si dhe popujt tjerë në Jugosllavi e kanë për detyrë, që të ngrejnë zërin dhe të e detyrojnë udhëheqësinë e LKJ dhe qeverinë e RSFJ që ta heq këtë presion nga Kosova sepse Kosova pa i realizu kërkuesat në REPUBLIKË nuk do të pushon as luftën politike dhe poqëse nuk pushon terrorri shtetëror kjo luftë do të ashpërsohet.

veprime terroriste për zgjatjen e pranisë së forcave të armatosura

Që nga pranvera e vitit 1981 krahina e Kosovës ndodhet nën mbikqyrjen e forcave të mëdha të ushtrisë e policisë të cilat nën hijen e tankseve dhe bajonetave mbajnë rendin e qetsisë të gatshme për të shuar në gjak qdo protestë të klasës punëtore e të popullit të Kosovës për shkak të padrejtësive të shuara që po i bëhen atij.

Me shpërthimin e demonstratave të përgjakshme drejt Kosovës vërshuan këto trupa të shumta të cilat vazhdojnë të jenë të stacionuara në vende të ndryshme të krahinës.

Kjo polici rankoviqiste inicoi shumë ekcese e bëri provokime për të ngjallë zemrimin e pastaj të bëjë kërdinë e të shuaj etjen prej gjakpirsisë që bëri gjat demonstratave që ishin krejtësisht paqësore e me kërkesa të drejta demokratike.

Nën presionin e vazhdueshëm të popullit të Kosovës për shkak të problemeve të shumta të cilat i iniconte policia e huaj, Qeveria kuislinge e Kosovës u detyrua të kërkojë largimin e trupave të huaja të policisë nën pretekstin se tani në Kosovë janë pranuar rreth 3000 polic të rinjë dhe këta janë në gjendje ta mbajnë

vet rendin e sigurisë. Siq bëhet e ditur një gjë e tillë kishte qenë para aprovimit: një për shkakun e lartë përmendur dhe dy ngase prania e tyre po i kushtonë shtrenjë Kosovës dhe Jugosllavisë si tërësi.

Mirpo serbomdhenjë duke mos qenë të ngopur akoma me gjakun e shqiptarëve, e duke kërkuar gjakderdhje të reja për ta shëndrruar Kosovën në një kasaphanë edhe më të madhe se që kanë shëndrruar, nxituan që me akcionet që i zhvilluan drejtë përsëdrejti ata të krijojnë gjendje pasigurie dhe ta zgjasin praninë e tyre në Kosovë.

Kështu komanda e policisë së huaj në Obiliq, angazhoi disa polic serb (lexo shovenist serb) për të shtier me armë zjarri në shokët e tyre për qëllim që do të akuzoheshin shqiptarët, dhe kështu për shkak të gjendjes së pasigurisë do të zgjatej edhe prezenca e tyre në Kosovë. Mirpo me syqllsin e popullit ata u zbuluan dhe akcioni i tyre shovenistë dështoi.

Megjithatë policia e huaj duhej të largohej qysh në janar të këtij viti ajo prap vazhdon të jetë prezente në Kosovë. Edhe pse zyrtarisht

nuk është pohuar, në realitetë pushteti në Kosovë qëndron në duar të policisë dhe ushtrisë.

Për gjat tër Kosovës vërehen forca të armatosura të ushtrisë e sidomos përgjat kufirit shqiptar nga e kanë frigën më së shumti. Në periferitë e qyteteve të Kosovës vërehen nga largë tytat e drejtuar të topave e tankseve drejt qyteteve me të cilat shovenistët serbomdhenjë mendojnë ta friksojnë popullin e pafrikshëm. Por mashtrohen armiqtë serbomdhenjë se shqiptarin nuk mund ta friksojnë me tyta topash e tanksesh. Po deshmë serbomdhenjë le të rrahisin tanket e topat nga Niishi e Beogradi gjer në Gjegjeli, por ato do të jenë vetëm lodra para forcës së pa tundshme të popullit.

Duhet ta dinë serbomdhenjë se edhe durimi i popullit ka kufi. Ai sot kërkon me mjete demokratike të njihen të drejtat e tij të garantuara, dhe po sju realizuan ato din edhe ai të përdorë forcën e armës por mendojmë që kjo e drejtë e tij duhet të realizohet me mjete paqësore, gjë që është jo vetëm në interes të Kosovës por edhe Federatës

RILINDJA

E martë, 8.11.1983

FILLOI GJYKIMI I PJESËTARËVE TË ORGANIZATËS ILEGALE
 ARMIQËSORE «PARTIA KOMUNISTE MARKSISTE — LENINISTE E
 SHQIPTARËVE NË JUGOSLLAVI»

ME VEPRIM, IDE E PLATFORMË ARMIQËSORE

● Pasi formuan organizatën armiqësore, në verë të vitit 1978, në shtëpinë e Abdullah Prapashticës në Prishtinë, si dhe u njohën me programin dhe ideologjinë e saj, disa nga të akuzuarit përcaktuan detyrat konkrete për aksionet e mëtejme. — Çfarë pseudonimesh kishin të akuzuarit dhe çka u shkruan organizatave shoqërore—politike në Krahinë? — Ditëne parë të shqyrtimit kryesor në pyetje u morën dy të akuzuarit e parë, Rexhep Maqedonci dhe Adem Prapashtica, të cilët deklaruan se nuk pendohen për veprimet e bëra

armiqësore

Në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, para trupit gjyqësor të të pestëve, e kryesor gjyqtari Mentor Çoku, dje filloi procesi gjyqësor ndaj 23 pjesëtarëve të organizatës ilegale armiqësore «Partia Komuniste Marksiste-Leniniste e Shqiptarëve në Jugosllavi», të cilët veprimtarinë e tyre armiqësore ndaj vendit tonë e filluan në vitin 1978 dhe e vazhduan deri në mars të vitit të kaluar. Në fillim të procesit të djeshëm, kryesor nga ana e zëvendësprokurorëve publikë, u lexua aktakuza, të cilën e përfaqësojnë Ruzhdi Kozmaqi dhe Reshat Millaku, e pastaj filloi marrja në pyetje e të akuzuarve të parë.

Kësaj organizate armiqësore, që të 23 të akuzuarit, kush më herët e kush më vonë, iu bashkuan me qëllime të caktuara dhe ideja, veprimi e platforma e tyre ishte fund e krye armiqësore ngase ata përdorën të gjitha mjetet në luftë kundër sistemit tonë socialist vetëqeverisës, kundër

vëllazërim — bashkimit e bashkëjetesës e kundër të gjitha fryteve të revolucionit tonë socialist dhe integritetit të vendit tonë. Të akuzuarit (shumica e tyre) Rexhep Maqedonci, Adem Prapashtica, Lutfi Maqedonci, Nysret Ahmeti, Kadri Cakiqi, Adem Dervisholli, Fatmir Grajçevci, Bahtir Ahmeti, Agim Ahmeti të gjithë nga Prishtina, pastaj Martin Çuni nga Gjakova, Neriman Braha nga Prizreni, Osman Maqedonci nga Prishtina, Arban Hoxha nga Gjiçani, Avdi Krasniqi nga Pejë, Naim Mahmudi nga Kërçova Ahmet Qeriqi nga Shtimja, Zenun Gjocaj nga Deçani, Hamzë Morina nga Klina, Sallah Jonuzi nga Ferizaj, Sabit Gashi nga Prishtina, Skender Vardari, shtetas turk, i lindur në Stamboll, Ahmet Islami si dhe Idriz Jusufi, që të dy nga Prishtina, ishin edhe pjesëmarrës të demonstratave armiqësore e kundërrivolucionare të marsit e të prillit të vitit 1981 në Kosovë, kur posaçërisht bënë agjitim për brohoritjen e parullës «Kosova republikë».

Sulm i paskrupull kundër rregullimit tonë shoqëror

Pasi të akuzuarit Rexhep Maqedonci, Adem Prapashtica, Lutfi Maqedonci, Nusret Ahmeti, Kadri Cakiqi dhe Adem Dervisholli, në shtëpinë e Abdullah Prapashticës në Prishtinë formojnë organizatën ilegale armiqësore «PKMLSHJ», në mbledhjen solemne që e hap Adem Prapashtica, e pastaj Abdullah Prapashtica e Osman Osmani, të cilat gjenden në arrati, njoftohen edhe me programin dhe ideologjinë e organizatës, si dhe përcaktojnë detyrat konkrete për aksionet e mëtejme dhe masivizimin e saj. Po kështu, ata marrin edhe

Kadri Cakiqi «Kulla», e kështu me radhë.

Këta të akuzuar, pas disa mbledhjeve të tjera, më 1 mars të vitit 1979 i dërgojnë «informatë» prej tetë faqësh Kryesisë së KK të LK të Kosovës e Kryesisë së KSA të Kosovës dhe kryetarit të RSFJ-së, shokut Tito. Më pastaj, më 30 maj të vitit 1979 përgatitin «Infor-



Nga gjykimi i djesmë i pjesëtarëve të organizatës armiqësore «PKMLSHJ»: i akuzuari Rexhep Maqedonci gjatë mbrojtjes së tij

KËMBËNGULËS PËR VEPRIMET ARMIQËSORE

I akuzuari Rexhep Maqedonci për veprimtarinë e tij armiqësore nuk mohoi asgjë, por në të kundërtën edhe më e plotësoi aktakuzën dhe detalisht shpjegoi rolin e tij në këtë organizatë, në të cilën ishte njëri prej «sekretarëve». Me këmbëngulje u mundua disa herë të bind trupin gjyqësor se «PKMLSHJ» u formua më 1975 dhe se platforma e saj u verifikuar më 1977, e jo një vit më vonë, si thuhet në aktakuzë.

Rexhepi tentoi disa herë të lexoj letrën që e kishte në dorë me të cilën do të tregonte «aftësitë» e tija dhe të arsyetojë (sipas idesë së tij armiqësore) kërkesën që Kosova të bëhet republikë. Madje, përkundër se e ndërpreu disa herë kryetari i trupit gjyqësor, ai prapë insiston të lexojë atë letër, që fund e krye ishte armiqësore.

Ai shfrytëzoi rastin të përsërisë akuzat që vijnë për çdo ditë përmes propagandës armiqësore nga udhëheqësia e Shqipërisë për «Revizionizmin dhe unitarizmin jugosllav», «për hegjemonizmin dhe shovenizmin serb», për gjoja «pozitën e pabarabart» të kombësisë shqiptare, e t.j. Ai nuk lejoi mbrojtësin e vet Zeqir Arnin që për të ta thotë asnjë fjalë.

Është interesant se sipas këtij të akuzuari, «Partia» e tyre «është formuar në principet e LKJ e të LNC-së» dhe se ideja për formimin e republikës shqiptare në Jugosllavi «është me vend dhe e drejtë». Kështu, përkundër të gjitha kamuflazheve dhe parullave demagogjike të «Partisë» së tij, edhe njëherë, qartë vërtetoi qëllimet e vërteta të kësaj organizate armiqësore dhe të anëtarëve të saj.

pseudonimet: i akuzuari Rexhep matën» prej tetë faqësh për Maqedonci merr emrin konspirativ situatën politike e ekonomike në «Kondori», Adem Prapashtica «krahinat shqiptare të bashkuara «I Qeti», Nusret Ahmeti «Neka», vullnetarisht Jugosllavisë», të

cilën ia dedikojnë organizatave politiko-shoqërore shqiptare në Jugosllavi dhe i dërgojnë në shumë adresa të organizatave politiko-shoqërore në KSAK si dhe i hedhin në disa oborre të shtëpive në Prishtinë, me të cilat informata botërisht njoftojnë strukturat shoqërore për ekzistimin e «PKMLSHJ» dhe qëllimet e saj, siç janë: bashkimi i krahinave shqiptare në RSFJ, pavarësia territoriale, politike dhe ekonomike nga RS e Serbisë, RS e Maqedonisë e RS e Malit të Zi dhe formimi i Republikës socialiste shqiptare në Jugosllavi». Më 11 mars të vitit 1980, në adresë të udhëheqësve më të lartë të KSAK dërgojnë «Letër interne» dhe «Notë». Pas vdekjes së shokut Tito, më 5 maj të vitit 1980, në emër të «Presidiumit të KQ» të «PKMLSHJ» i dërgojnë telegram ngushëllimi Kryesisë dhe KQ të LKJ. Ndërsa, më 10 dhjetor të vitit 1980, strukturave shoqërore-politike shoqërore i dërgojnë «Projektin» e materialit të organizatës së tyre ilegale armiqësore, në formë të broshurës prej 150 faqesh, së bashku me «Dekretin» ku jepet urdhrë që brenda vitit 1981 të kryhen detyrat programore lidhur me shpërthimin e demonstratave armiqësore e kundërrivolucionare. Anëtarët e kësaj organizate, më 11 e 26 mars dhe 1 e 2 prill të vitit 1981 plasojnë platformën e tyre dhe marrin pjesë aktive në demonstrata dhe insistojnë në mesin e demonstruesve që të përdoret parulla «Kosova Republikë» e pastaj shkruajnë parulla dhe shpërndajnë afishe me përmbajtje armiqësore. Më 14 prill të vitit 1981, i dërgojnë «notë», KQ të LKJ me çrast marrin përgjegjësinë për organizimin e demonstratave.

Po këta të akuzuar, më 30 maj të vitit 1981 i dërgojnë letër KK të LK të Kosovës, të gjitha komitetetve komunale, të gjitha sekretariatetve të punëve të brendshme në Kosovë, ku bëjnë fjalë për gjendjen politike e ekonomike të viseve shqiptare në Jugosllavi. Më 5 qershor të të njëjtit vit i dërgojnë letër Kryeredaktorit të «Borbës», Marko Loliqit. Më 14 gusht 1981, KQ të LKJ dhe qeverisë jugosllave i dërgojnë «Letër» dhe ftojnë LKJ-në për bisedime si partner e parti të barabarta». Aktivitetin e tyre ilegal armiqësor ata pastaj e vazhdojnë me shtypjen dhe shumëzimin e fletushkave: «Teoria dhe praktika e revolucionit», «Revolucioni», «Zëri i atdheut», etj në të cilat fletushka në mënyrë të paskrupull sulmohet rregullimi shoqëror në RSFJ. Ata shkruajnë edhe afishin dedikuar pionerëve dhe një afish formë letre me të cilën u drejtohen pjesëtarëve të kombësisë serbe, maqedonase e pjesëtarëve të tjerë që jetojnë në viset ku banojnë shqiptarët.

Kur u formua organizata armiqësore «PKMLSHJ»?

I akuzuari i parë, Rexhep Maqedonci, në mbrojtjen e tij, që në fillim deklaroi fillim nuk pajtohet me thënie të aktakuzës duke shtuar se nuk janë themelues të organizatës armiqësore «PKMLSHJ». Sipas tij, kjo organizatë u formua më 1975 e jo më 1978. Si thotë, në verë të vitit 1977, në shtëpinë

Abdullah Prapashticës në Prishtinë kanë mbajtur mbledhjen solemne ku kanë vendosur të vepronë sipas platformës së kësaj organizate. Aty kemi marrë pseudonimet dhe kemi bërë përgatitjet që të formojmë një grup që të vepronë sipas «PKMLSHJ». Themelues i këtij grupi jam unë, ndërsa mbledhjen e ka hapur Adem Prapashtica. Ishin të pranishëm edhe Abdullah Prapashtica, Skender Prapashtica, Nysret Ahmeti, Osman Osmani, Faton Topalli, Kadri Cakiqi dhe Adem Prapashtica. Lutfi Maqedonci bënte roje dhe as që ka ditur për qëllimet tona. Në mbledhje vendosëm që të punojmë për realizimin e statusit «Kosova republikë», të vepronim sipas platformës së «PKMLSHJ» si dhe të shkruajmë materiale të ndryshme. Më pastaj, Rexhep Maqedonci tregoi se si i kanë shkruar disa informata në adresa të organizatave shoqërore - politike të Krahinës, që vetë i ka hedhur në sandëqet e postës. Tregoi ai edhe si ka shkruar në kursin njëmuajor për milic në Vuçiternë dhe me çfarë qëllimesh e ka kryer këtë detyrë pastaj në Prizren.

Në, tha në vazhdim ky i akuzuar, kemi ndjekur vazhdimisht reagimet e organeve shoqërore - politike lidhur me informatat që ua dërgonim dhe kemi konkluduar se «është trasuar rrugë e mirë që aktiviteti dhe puna e «PKMLSHJ» të shkojë edhe më përpara». I akuzuari i dytë, Adem Prapashtica, pasi shpjegoi mënyrën se si kanë mbajtur mbledhje me rastin e formimit të organizatës armiqësore, tregoi se ka marrë pjesë në demonstratat e 26 marsit të 1 e 2 prillit të vitit 1981 dhe se në këto të fundit ka brohoritur parulla armiqësore dhe ka shpërndarë afishe. Thotë se nuk ka qenë i lidhur drejtpërdrejt me këtë organizatë armiqësore dhe as që ka ditur se ekziston ajo. Edhe ky, sikurse Rexhep Maqedonci, deklaroi se nuk pendohet, megjë konsideron se nuk ka bërë asgjë të keqe gjatë veprimtarisë armiqësore.

Gjykimi vazhdon sot me marrjen në pyetje të të akuzuarve të tjerë.

H. SYLA



NGA E DJATHTA NË TË MAJT: REGJEP MAQEDONCI, ADEM PRAPASHTICA DHE LUTFI MAQEDONCI.

proces i montuar gjyqsor

Në muajin Shkurt të këtij viti në Prishtinë u zhvillua një ndër proceset më të mëdha gjyqsore ndaj shqiptarve të Kosovës, ku armiq të serbomdhenjë qjerrën ç'domaskë të humanitetit njerzorë dhe të "demokracisë socialiste" që aq me zell e propagandonin. Në bangën e të akuzuarve u nxorën njëzet e tre veta në mesin e të cilëve punëtorë, nxënës, studentë, profesorë e gazetar, të cilët akuzuarve të akuzuarve të tjerë.

ohen se kan qenë anëtarë të PARTIS KOMUNISTE MARKSISTE - LENINISTE SHQIPTARE NE JUGOSLLAVI dhe se me veprimet e tyre revolucionare që nuk kan cenuar kushtetutën e RSFJ dhe programin e LKJ, paskan vepruar në thyerjen e "bashkim-vëllazërimin dhe sistemt të vetqeverisjes socialiste.

Për të treguar se sa absurdë janë serbomdhenjëjt dhe veglat e tyre në Kosovë, po e botojmë tërsisht artikullin e gazetës "RILINDJA" të botuar me rastin e ditës së parë të gjykimeve ku vërtetohet se sa kontraditore janë deklaratat dhe veprimet e serbomdhenjëve. Të akuzuarit aktakuza i ngarkon për irredentizëm, dhe pikrisht këtu shifet kontradita e tyre kur vet deklarojnë se qëllimet e PKMLSHJ janë bashkimi i krahinave shqiptare në RSFJ, pavarësia ekonomike politike dhe teritorijale nga RS e Serbis, Malit të Zi dhe Maqedonis dhe themelimi i Republikës Socialiste Shqiptare në kuadër të RSFJ. Atëherë ku ka vend këtu akuza për irredentizëm dhe kodifikimi i veprës për një veprimtari të tillë gjë që tregon se procesi gjyqsorë fund e krye është i montuar dhe paraqet ligësi të organizatorëve të tij.

Të akuzuarit që nga Regjep Maqedonci, Adem Prapashtica, Nysret Ahmeti e gjer tek i fundit hodhën poshtë akuzat për nacionalizëm e irredentizëm. Ata mbrojtën me vendosmëri kërkuesën për Republikë realizimin e së cilës e kërkoi mbarë populli i Kosovës së tërsishme. Shum nga të akuzuarit nuk kanë qenë anëtarë të PKMLSHJ pos që kan lexuar ndonjë nga gazetatat e PKMLSHJ si Organin e Komitetit Qendror "REVOLUCIONI" Organin e ORK "ZERI I ATDHEUT", veprën programore "TEORIJA DHE PRAKTIKA E REVOLUCIONIT" si dhe trakte e materjale të tjera të Partisë dhe kjo u ka mjaftuar serbo-

mdhenjëve për ti denuar, me denime dragonijane që janë shkelje flagrante e kushtetutës së RSFJ.

Për shkak të kërkesave të drejta demokratike, të mbështetura në kushtetutën dhe ligjet e RSFJ, këtij grupi iu shqiptuan denime të rënda nga 1 gjer në 14 vjet burg. Kështu i akuzuari i parë Regjep Maqedonci u denua me 14 vjet burg, Adem Prapashtica 11 vjet, Nysret Ahmeti 10, Fatmir Grajqevci 9, Martin Quni, Ahmet Qeriqi, Sabit

Gashi e Skender Vardari me nga 8 vjet, Meriman Braha e Avdi Krasniqi me nga 7, Lutfi Maqedonci, Kadri Cakiqi, Adem Dervisholli e Zennun Gjocaj me nga 6 vjet, Bahtir Ahmeti, Osman Maqedonci, Arban Hoggja, Hamzë Morina e Ahmet Islami, me nga 5, Sallah Jonuzi 3, Naim Mahmudi e Idriz Jusufi me nga 2 vjet dhe i fundit Agim Ahmeti me 1 vjet burg. I akuzuari i parë Regjep Maqedonci, Lutfi Maqedonci dhe Osman Maqedonci janë vëllëzër e po ashtu edhe i akuzuari i tretë Nysret Ahmeti dhe Bahtir Ahmeti

Denimet e rënda ndaj këtyre njerzve që akuzohen si pjestar të PKMLSHJ tregojnë se në Jugosllavinë Socialiste vetqeverisëse komunistët ndiqen dhe persekutohen më shum se në kohën e "obznanës" së Jugosllavisë së kralëve.

Terori gjyqsorë ndaj shqiptarve të Kosovës hasi në reagim të ashpër të opinionit të brendshëm dhe të atij të jashtëm progresiv, dhe këtë e vërtetojnë edhe artikujt e shtypit botërorë.

Fushata e denimeve të egra nuk ka pushuar asnjëherë që nga pranvera e vitit 1981 e gjer më sot, megjithse një numër i madh i proceseve gjyqsore nuk janë publikuar fare para opinionit të brendshëm publik dhe atij të jashtëm. Kjo fushatë që ka për qëllim shuarjen e rezistencës me masa dhune e terori, po tregohet e pasukseshme. Denimet e rënda nuk janë faktor që qetsojnë gjendjen e rëndë politike në Kosovë. Kjo do të thotë që pa iu njohur Kosovës statusi i Republikës në Jugosllavi do të mbretërojë gjendje pasigurije.

ME RASTIN E FESTES SE PROLETARIATIT BOTROR

-pjesë nga trakti "PUNËTORË,,

Kudo në botë janë vënë në lëvizje turbinat e revolucionit, popujt e shtypur e të shfrytëzuar nga imperjalizmi, socialimperjalizmi dhe reaksioni Botërorë kërkojnë bukuri, drejtësi e sovranitet kombtar. Në zemrat e tyre zihen zjarri i luftës, zjarri i revolucionit proletarë, ai zjarr që është shëndrruar në "erupcion" vullkanik duke i vënë në lëvizje të shpejtë makinerit e revolucionit proletarë.

Qindra e mijëra punonjës, anë e mbanë rruzullit toksorë janë në pregaditje për të e shenuar me greva, demonstrata e protesta ditën e solidaritetit ndërkombtarë të punëtorëve 1 Majin. Zemrat e tyre i ka mbërthyer entuziazmi i lartë revolucionar, fitoret e shumta në barikatat klasore u kanë dhënë kurajo për betejë ardhshme, e shpresa të forta për ta fituar luftën që po e zhvillojnë punëtorët në të gjitha vendet e botës kapitalisto-revizjoniste.

Nëntëdhjetë shtat vite më parë, me 1 Maj të vitit 1886 pesdhjet mij punonjës të qytetit Qikago të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, dolën me flamuj të bardhë rrugve të qytetit për të kundërshtuar e për të demonstruar kundër shtypjes e shfrytëzimit të egër klasorë, por gjakpirsët e egër kapitalistë, flamujt e bardhë që valonin lartë në duart e punonjësve të shtypur i skuqën me gjak. Me gjakë u shuan demonstratat e Qikagos me gjakë u lanë rrugët e qytetit. Tre vite më vonë, me 1889 Internacionalja e Dytë që u themelua me iniciativën e Frederih Engelsit, me 14 Korrik, morri vendim që 1 Maji të shpallet ditë e solidaritetit ndërkombtar të punëtorëve, ndërsa flamujt e bardhë që atë ditë u skuqën me gjakun e

punëtorëve të mbesin flamuj të proletarve dhe që nga ajo ditë me flamuj të kuq qindra e mijëra punonjës, miliona popuj të shtypur e të shfrytëzuar ngriten, bëjnë greva, protestojnë e demonstrojnë duke e goditur rëndë kapitalizmin me akcione revolucionare.

1 Maji i këtij viti po afrohet me një atmosferë të lartë revolucionare në botë. Vatrë e revolucionit zihen në Evropë, Azi, Amerikë, Afrikë,

"NJË FANTAZMË SILLET NËPËR EVROPË- FANTAZMA E KOMUNIZMIT TË GJITHA FORCAT E EVROPËS PLAKË,,, JANË BASHKUAR PËR TI BËRË LUFTËN E SHENJËT KËSAJ " FANTAZME ". Kështu shkruante Karl Marksi një shekull më parë por një konstatim i tillë mbeti i gjallë i freskët dhe realitet i fuqishëm i ditve tona. Evropa është shëndrruar në një kartë bigjozi për kapitalistët, në një territor lufte për dominim dhe



Australi dhe popujt e këtyre, vendeve me armë në dorë e forma të tjera të luftës, janë hedhur në luftë kundër imperjalizmit e socialimperjalizmit, kundër politikës së tyre grabitqare e luftënxitse. Luftërat e ashpëra në Solvador të Amerikës Latine kundër imperjalizmit amerikan, luftërat e popujve arab, lufta e populli afgan tregojnë për atmosferën e denjë revolucionare në Botë dhe vetëdijen gjithnjë e më të lartë dhe gadishmërinë e proletarijatit për tu hudhur në luftë kundër shtypjes e shfrytëzimit të egër klasorë.

fuqi baroti nga superfuqitë. Miliona njerz të papunë në shtetet kapitaliste dhe revizioniste bredhin metropoleve të Evropës. Krizat e ndryshme ekonomike në këto shtete që janë karakteristikë e njohur e fazës më të lartë të kapitalizmit - imperjalizmit, po rëndojnë mbi masat punonjëse dhe kudo në këto vende kanë nxitur val protestash; greva e demonstrata.

Masat punonjëse kërkojnë paga më të larta, kushte më të mira pune, protestojnë kundër shkallës së lartë të papunësisë e pranisë së



forcave të huaja ushtarake në vendet e tyre. Këto greva demonstrata e protesta të shumta, po hasin në reaksion të fortë me kapitalistët, të cilët po e luftojnë klasën punëtore dhe Komunizmin pikrisht ashtu siq shkruante Marksi - si "fantazmën "Armiqë kapitalisto-revizjonist bënë përpkje të mëdha për ta diskredituar ideologjinë e klasës punëtore dhe një ndër fitoret më të mëdha të kapitalizmit që përhapja e revizionizmit. Por edhe pse u bënë orvatje të shumta në këto drejtim, marksizëm-leninizmi, mbetet një ndër armët më të forta në duart e klasës punëtore, armë e re e fuqishme dhe gjithmonë vitale.

Sot Evropa po lëvizë e tëra, popujt e shtypur me zingjirë në fyt nga imperjalizmi amerikan dhe socialimperjalizmi sovjetik kan ngritur lartë zërin kundër politikës së tyre ekspansioniste e garbitqare.

Miliona punëtorë Italian protestojnë, bëjnë greva e demonstrojnë për shkak të shpjes e shfrytëzimit kapitalist. Eurokomunistët Italian nuk ia kan dalë në krye ta largojnë klasën punëtore nga rruga e revolucionit si rrugë e vetme për fitoren e saj, dhe kjo tregon që kapitalizmi po has në dështime të vazhdueshme. Vala e lartë e protestave është prezente edhe në Gjermani. Miliona punëtorë gjerman protestojnë e demonstrojnë kundër armatimit bërthamorë, kundër bazave të shumta ushtarake të imperjalizmit Amerikan në teritoret gjermane. Miliona punëtorë të tjerë demonstrojnë në Francë, Britaninë e Madhe, Greqi, Jugosllavi e vende të tjera.

Kapitalizmi mund të jetë gëzuar duke menduar që me arritjen e fitores së revizionizmit, është " larguar " rreziku i Komunizmit nga ato vende, por siq po shifet koha po e vërteton të kundërtën. Në një varg shtetesh të ashtuquajtura " Socjaliste " të cilat e kan tradhëtuar klasën punëtore duke kaluar në tradh-

ëtinë revizioniste e duke iu bashkangjitur kapitalizmit, mbretërojnë situata krize politike, gjendjeje të jashtëzakonshme shtetrrëthimi për shkak të revoltës së lartë të klasës punëtore.

Rasti i Polonisë ka vërtetuar që revolucionin mund të shpërthejë dhe ngadhënjë edhe në vendet revizioniste, por mëson edhe që duhet ruajtur nga reaksioni botërorë.

Barikadat klasore janë vendosur edhe në Jugosllavi. Popujt e shtypur e të shfrytëzuar e kan kuptuar të vërtetën dhe mashtrimin nga borgjezija andaj dhe protestojnë e luftojnë për të rivendosur pushtetin e klasës punëtore dhe diktaturën e proletarijatit.

Dy vitet e fundit në Krahinën e Kosovës dhe viset tjera shqiptare në Jugosllavi l Maji po vjen i përgjakur. Dhuna dhe terrori i egër që ka vërshuar mbi popullsinë shqiptare dhe klasën punëtorengana e shovenistëve serbomdhenjë, dhe reaksionit maqedonë e malazezë për shkak të kërkesave të drejta demokratike, për konstituimin e Republikës Socjaliste Shqiptare në Jugosllavi, kan shëndrruar Kosovën në kasaphane, në vend dhune, terrori e gjaku.

Klasa punëtore e Kosovës e bindur në forcën e saj nuk e ka pushuar luftën asnjëherë, për ti realizuar të drejtat e për ti shkëputur prangat e shtypjes së egër kombtare e shfrytëzimit klasorë.

Punëtorët e Kosovës të udhëhequr nga mësimet e marksizëm-leninizmit dhe pararojës së tyre revolucionare kan besim në fitore dhe nuk do të kursëjnë asgjë në luftë kundër borgjezis e shovenizmit serbomadhe dhe borgjezis shqiptarë - Qeverisë kuisinge të Kosovës.

Sot përshkak të "bujarisë" së sistemit "ideal" të vetad ministrimit, mijëra punonjës shqiptar i janë shitur borgjezisë së Evropës perendimore, duke i ndarë nga familjet e tyre e atdheu për t'ia shëruar

kapitalistëve perendimorë që ta shfrytëzojnë egërsisht fuqinë e krahve të tyre.

Botuam pjesë nga trakti të cilin BPK e shpërndau me rastin e festës së Një Majit.

në shënjestër të rankoviqizmit

Ekaluara e përgjakshme historike e popullit shqiptarë betejat e lavdishme, heroizmi i rrallë, guximi, trimërija, ndjenja e lartë e atëdhedashurisë dhe sakrifica për çështjen e popullit dhe të atëdheut, janë elemente që pasqyrohen fuqishëm në këngët tona popullore, ato janë burim i përhershëm frymëzimi tek populli ynë, mjete që embajrë përher gjall frymën kombtare, përkujtojnë të kaluarën dhe nga kjo del se nuk është aspak e çuditshme pse qeverija e Beogradit në krye me shovinistët serbomdhenjë jan vërsulur aq tërbueshëm mbi kulturën dhe folklorin shqiptar duke e vënë nën kontrollin e rreptë të censurës.

Mjafton të përmendim se menjëherë pas ngjarjeve revolucionare në Kosovë, të Marsit, Prillit dhe Majit të vitit 1981, nën presionin e UDB-esë u pasivizuan me dhunë ushtarake e policore të gjitha shoqëritë kulturo-artistike të cilat kishin lulëzuar e marrë hov para ngjarjeve, mirpo edhe atëherë ishte e pranishme cenzura por jo në masën që është sot e që është identike me periudhën famkeqe njëzet vjeqare të Rankoviqit, gjë që argumenton kthimin e Rankoviqit, në mos atij drejtë përsëdrejti, atëher rankoviqizmit si rryme në pushtet.

↓ Serbomdhenjëti i kanë studjuar me vëmendje veqoritë kryesore tek populli shqiptarë, sidomos ato karakteristika që mbajnë gjallë frymën kombtare dhe mesiguri që sulmon në pika të ndjeshme siq ka sulmuar edhe më parë. Këtu e bën ç' do armikë ç' do kolonizatorë para e pas pushtimit dhe pastaj vazhdonë me të gjitha mjetet e mundshme për ta futur popullin e robëruar në rrugën e asimilimit. Kështu janë zhdukur shumë popuj të vjetër e madje edhe më të mëdhenjë se Populli Shqiptar. Ndër masat, që çojnë drejtë rrugës së asimilimit është edhe kjo e cezurës së folklorit shqiptarë nga ana e shovenistëve serbomdhenjë që ka për qëllim edhe pengimin e afirmimit të mëturjes së vlerave kombëtare.

Sot në Kosovë janë të ndaluara mëse 3/4 e këngëve popullore gjoja për shkak që ato përmbajnë një "dozë" nacionalizmi" edhe pse në të vërtetë ato nuk mbajnë as një, fije nacionalizmi pos pasqyrimin real të së vërtetës historike, dhe për këtë arsye në valët e radios që nga koha e rikthimit të rankoviqizmit në pushtet nuk kemi ndërgjuar as një këngë kushtuar heronjëve ton kombtar si Hasan Prishtinës, Isa Buletinit, Shote Galicës e madje as atyre që ranë heroikisht nga plumbat e fashistëve si Emin Durakut, Hajdar dushit e të tjerëve.

Këngët tona u ndaluan e u bënë vepra penale të pa qenë të tilla fare. Ne nuk kemi fajtorë që historia e popullit tonë është e tillë, një e kaluar e përgjakshme, me plot luftëra e beteja, përplotë trima heronjë e heroina.

Ata dhanë jetën për popull dhe populli do të ju këndojë, brez pas brezi edhe po denuan serbomdhenjëti me burg të përjetshëm siq i denojnë tani njerz të vetëm pse kanë kënduar, ndonjë këngë në ndonjë dasmë e gëzim tjetër.

TË VEGJËL

Nuk është aspak për t'u nënçmuar e nënvleftësuar roli i pionierëve, kontributi që dhanë ata në të kaluarën dhe që po japin edhe sot në lëvizjen e përgjithshme të masave për liri, barazi e pavarësi.

KOSOVA REPU



Përkundrazi, punën e tyre duhet ta marrim me seriozitet e t'u kushtojmë kujdes të veçantë, t'i aftësojmë e t'i përgadisim që sa më masovikisht

t'i fusim në radhët e luftës, si forcë nga e cila në të ardhmen do të mvaret fati i atdheut.

Pionierët janë një brezë i ri që po rritet në zjarrin e luftës, në vuajtje, janë brez që po e shijojnë dhunën e terrorin e egër, si të rriturit madje duke mos u kursyer as nga plumbat e serbomdhenjëve, të cilët të vërbuar nga hegjemonizmi dhe shovinizmi, bëjnë akte të rënda kriminele.

Duke i natyr parasysh këto lirisht mund të themi se edhe tek pionierët, të cilët; panë me syt e tyre dhe ndinë deri në kockë terrorin e serbomdhenjëve; mbetën pa prindër, vëllezër e motra, shokë e shoqe prej të cilve sa u vranë e u sakatosën sa dirgjen burgjeve të Jugosllavisë vetëm pse në rrugë paqësore, të ligjshme e kushtetutare kërkuan realizimin e të drejtave të tyre, është vulosur urrejtja e pakufi ndaj armikut shovinist e ndaj padrejtësive shoqërore, është zgjuar ndjenja e atdashedhurisë e cila do t'i shtyjë vazhdimisht në aksione të guximshme e revolucionare, që janë karakteristike për natyrën e pionierëve.

Që nga mbarimi i Luftës së Dytë Botërore, kur populli i Kosovës së tërsishme u tradhtua, pionierët si edhe shtresat tjera të popullsisë në Kosovën e tërsishme nuk janë të organizuar në ndonjë organizatë të tyren, kosovare-shqiptare, e cila do t'i edukonte; drejtë, në frymë kombtare dhe socialiste.

Në Kosovë egziston "Organizata e Pionierëve" e cila, si edhe organizatat tjera të masave në krye me LK të Kosovës janë të organizuara dhe udhëhiqen nga programet e përpiluarua prej forcave reaksionare në LKJ dhe në RSFJ dhe si të tilla këto programe kishin dhe kanë për qëllim të

drejtojnë pionierët në rrugën qoroditëse, të degjenerimit të asor dhe kombëtar, që qonte në asimilim dhe në zhdukje të çdo ndjenje nacionale e njerzore.

Me themelimin e Organizatës së Rinisë, më 1979, që drejtohej nga PKMLSHJ, pionierëve ju kushtua një kujdesë më i madh, gjegjësisht me iniciativën e ORK-ës erdhi edhe deri tek formimi i organizatës së pionierëve e cila filloi të veproi ilegalisht nën mbikqyrjen dhe drejtimin e Rinisë.

Organizata e parë e pionierëve shqiptar të Kosovës dhe krahinave tjera shqiptare nën Serbi, Maqedoni dhe Mal të Zi, u quajt "GUERILA E PIONIERVE SHQIPTAR". Nga kjo kohë kemi një aktivitet më të organizuar të pionierëve e më efektiv.

Dhe, kjo nuk vjen vetëm si rrjedhim i organizatës së tyre, sepse ato janë grupe simbolike në krahasim me masën e gjërë të pionierëve në Kosovë dhe viset tjera shqiptare në Jugosllavi, por kjo vjen edhe si rrjedhim në të cilin, pos faktorëve tjerë, në masë të madhe ka ndikuar edhe ngritja e vetëdijes kombëtare e klasore tek masat e gjëra shqiptare në Jugosllavi.

Njerëz të ndryshëm mund të kenë edhe konceptione të gabuara për këtë çështje dhe punën e pionierëve të mos e marrin me seriozitet të plotë, por do t'i bindë fakti, sepse, ata janë e ardhmja e vendit; Janë burim i pashterrshëm i kuadrove, të cilat përgaditen e aftësohen shpejt për veprimet të nivelit më të lartë në Organizatën e Rinisë e pastaj edhe më tutje.

Duke u futur në veprime revolucionare që nga fëmijëria ata do të kaliten e do të forcohen dhe pastaj nga ta do të dalin kuadro të forta e me përvojë të gjatë në aktivitetin revolucionar e patriotik. Organizata e Rinisë me ta do të jetë e freskët e re dhe e fuqishme.

Nga përvoja e viteve të fundit e dijmë se sa shpejtë aftësohen e ç'kontributojnë pionierët, por vetëm duhet të punohet me ta.

GJendja e rëndë ekonomike dhe politike që e ka përfshirë krahinën e Kosovës, si dhe viset tjera shqiptare në Jugosllavi, që vjen si rrjedhim i organizimit kapitalist, por para së gjithash i politikës, antishqiptare që po udhëheqin shovenistët serbo-malazezo-maqedonomëdhenje, po bëhet gjithnjë e më e ndërlikuar dhe është shëndruar në një "kancer", të cilit po nuk iu dha "bari i kërkuar" do të bjenë në rrezik egzistencën e RSFJ.

Po e shiquam të kaluarën historike (në çka thirren shpesh shovinistët serb dhe veglat e tyre në Kosovë) del se prapambeturia e Kosovës i ka rrënjët që nga ato vite kur Serbia imperialiste me ndihmën e Fuqive të Mëdha e sidomos të Rusisë cariste, arriti të aneksoi gjysmën e trojeve shqiptare e që pastaj vazhdoi të thellohet deri në ditët e sotme.

Përkundër që është njëri ndër vendet më të pasura me begati natyrore në Jugosllavi e Europë, në zhvillimin ekonomik ajo zen vendin e fundit dhe dekada me radhë ballafaqohet, me probleme të shumta ekonomike që janë rezultat i politikës politike të Kosovës së tërsishme, në fderatën Jugosllave, e cila zyrtarisht ka statusin e krahinës autonome, por në realitet është një koloni e thejshme e Serbisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë, e ndarë me kohë për t'u shfrytëzuar e sunduar më lehtë.

Të dhënat zyrtare tregojnë se Kosova është një vend shumë i begatshëm dhe me pasuritë rralla nëtoksore. Kështu në teritorin e ngushtë të saj gjinden 67% të rezervave të përgjithshme të zingut e plumbit në Jugosllavi, 24% të rezervave të niklit dhe hekurit, 28% të rezervave të magnëzit, ndërsa rezervat e thëngjillit të zbuluara viteve të fundit arrijnë 12 miliard tonë dhe përbëjnë 64% të të gjitha rezervave të këtij lloji në Jugosllavi, por me të gjitha këto ajo prap se prap është më e varfëra dhe më e pazhvilluara.

mvarësia politike sjell prapambeturinë ekonomike

Industria është e zhvilluar në një shkallë mjaft të ulët edhe atë në degët të cilat ia sigurojnë lëndët e para industrisë së zhvilluar të Serbisë. Trepça, njëri ndër prodhuesit më të mëdhenjë të plumbit dhe zingut, jo vetëm në vend dhe Evropë por edhe më gjërë, nuk prodhon gjë tjetër pos lëndëve të para dhe ndonjë prodhim të rrallë gjysëm final, për kundër që janë të gjitha mundësitë që prodhimet e saj të finalizohen. Por, një gjë të tillë është e pamundshme ta bëjë Kosova përderisa ndodhet nën sundimin e Serbisë. Serbija do të pengon vazhdimisht zhvillimin e industrisë në Kosovë e sidomos finalizimin e prodhimeve, për arsye se kjo do të pengonte Serbisë e do t'ia bënte të pamundur zhvillohet në kurriz të Kosovës atëherë të gjitha prodhimeve finale do t'u caktohej qmimi në Kosovë dhe Serbija nuk do t'ua caktonte qmimet mëse të ulta siq vepron tani.

Një vend me rëndësi në ekonominë e Kosovës zen edhe kombinati "Kosova" në të cilin përfshihen minjerat e qymyrgurit dhe termoncentralet e Obiliqit me një kapacitet prej 800 000 kilovatësh. Ky objekt gjigant është rritur dhe po vazhdon të rritet jo për të zhvilluar ekonominë e Kosovës, por për të eksplatuat pasuritë e nëntokës së Kosovës duke e lënë këto në një gjendje shumë të rëndë ekonomike. Të dhënat zyrtare tregojnë se nga sasia e përgjithshme e energjisë të kombinatit "Kosova" më shumë se 2/3 shfrytëzohen nga republikat tjera të Jugosllavisë; Serbija, Mali i Zi, Maqedonia etj. Nevojat e Kosovës për energji elektrike do të plotësoheshin edhe me ndonjë

PAPUNËSI MASIVE NË

KOSOVË

objektë edhe më të vogël, por ky po zgjerohet vazhdimisht nën kujdesin e Serbisë dhe shifra 2/3 që shfrytëzohen nga republikat tjera, tregon dhe faktin se ky objekt nuk po zgjerohet për t'u zhvilluar e për të përpëruar Kosova, por për ta varfëruar atë duke e eksploatuar vazhdimisht.

Edhe bujqësisë së Kosovës, si dhe lëmive tjera ekonomike nuk i është kushtuar as kujdesi më i vogël. Ajo është lënë në mëshirën e fatit, përkundrajt që zenë vendin kryesor në ekonominë e Kosovës. Afër 80% të tokave i takojnë sektorit privat. Toka pjellore shfrytëzohet për ndërtimin e objekteve të ndryshme joekonomike, të cilat shkaktojnë dëm të mëdha në bujqësinë e Kosovës, përdërisa ajo tokë mund të përdoret për të siguruar fitime të mëdha e në këtë kuadër do të e zgjidhte në masë të mirë problemin e punësimit. Edhe prodhimet e bujqësisë kryesisht shiten si lëndë të para me çmime shumë të ulëta e prodhuesit nuk ia arrijnë t'i mbulojnë as hargjesat e lehtë më të fitojnë.

Turizmi ka mundësi të mëdha për zhvillim, por edhe kjo lëmi është shumë e pazhvilluar, dhe për nevoja të tij janë të ndërhuara vetëm disa objekte të vogla turistike me kapacitete minimale e të paafirmuara fare për shkak të konkurrencës që do t'i bënin ato vendeve tjera turistike në Serbi e gjithë në Jugosllavi.

Përkundrajt pasurive dhe mundësive të shumta që i ka për një zhvillim të shpejtuar, ekonomia e Kosovës po përjeton një degradizim të madh. Problemet ekonomike në Kosovën e tërësisht janë më theksuara se në ç'do republikë tjetër të RSFJ dhe këto probleme janë të lidhura ngusht me pozitën politike të Kosovës së tërësisht.

Kërkesat e drejta të klasës punëtore dhe popullit të Kosovës së tërësisht për pavarësi politike e ekonomike e barazi klasore e nacionale që do të kurorizoheshin me konstituimin e Republikës Socialiste Shqiptare të Kosovës në kuadër të RSFJ; ishin kërkesa realizimi i së cilave do t'u ipte fund problemeve politike e ekonomike në Kosovë. Pikërisht për shkak të pozitës së saj politike, Kosova ndodhet 50% mbrapa mesatares jugosllave. Përqindje kjo, që me kalimin e kohës po vjen duke u thelluar. Me konstituimin e RSSH të Kosovës, Kosova do të kishte mundësi që ekonominë e vet ta udhëheqë dhe ta zhvillojë sipas nevojave të veta. Konstituimi i RSSH të Kosovës do t'i ipte fund edhe shfrytëzimit të pasurisë së Kosovës nga të huajt, do t'i ipej fund diskriminimit nacional dhe shfrytëzimit të djersës së klasës punëtore.


Duke planifikuar vet ekonominë e vet, Kosova do t'i kushtonte kujdes finalizimit të prodhimeve të ndryshme.

Pikërisht pse konstituimi i RSSH të Kosovës do t'i ipte fund shtypjes dhe shfrytëzimit nga ana e Serbisë dhe të tjerëve, shovinistët serbomëdhenj janë lëshuar me aq tërbim kundër klasës punëtore e popullit të Kosovës dhe kërkesës së tyre të drejtë e demokratike dhe me shumë fitime jo vetëm për Kosovën por edhe për RSFJ si bashkësi, themel et e së cilës do të forcohej shpesh në pikën më delikate.

Klasa punëtore dhe populli i Kosovës së tërësisht më forcën e drejtësisë dhe përkrahjen e forcave progresive në RSFJ do të arrijnë këqijë qëllim, i cili do ta thellon barazinë kombëtare në vepra e jo me fjalë e demagogji si po veprhet tani.

Papunësia masive në krahinën e Kosovës ka ndikuar që problemet ekonomike dhe politike të kenë një theks edhe më të madh. Sipas statistikave më të reja në Kosovë numrohen diku rreth tetëdhjet mij të papunë duke i mos llogaritur pesëdhjet mijë të tjerë që përkosishtë janë të punësuar në vende të ndryshme të Evropës perendimore.

Siq bëjnë të ditur burimet zyrtare në Kosovë numri më i madhë i të papunëve janë të rinjë të cilët i kanë të përfunduara shkollat e mesme por kohëve të fundit para enteve, për inkuadrim, pret dhe një numër i madhë të rinjësh me fakultete të përfunduara. Siq bën të ditur gazeta "RILINDJA" në artikullin "Masë e barzisë faktike kombëtare" të datës 4 Shtatorë 1982 nga tetëdhjet mij vetë që kërkojnë punë 35% i kanë të kryer shkollat e mesme, të larta e fakultetet. Gjendja sociale e të rinjëve Kosovarë është shumë e rëndë. Nga numri i përgjithshëm i të papunëve, bën të ditur gazeta "RILINDJA" e të së njejtës datë, 82% nuk kanë egzistencë të siguruar. Papunësia në masë ka ndikuar që të jetë aq e lartë protesta e të rinjëve por veqanërisht problemet e shumta nacionale të pazgjidhura. Për shkak të gjendjes së rëndë sociale, shumë të rinjë janë detyruar të migrojnë vendeve të ndryshme të Jugosllavisë për të punuar kryesisht punë të rënda fizike me meditje të ulta. Kur bëhet i ditur fakti se brenda tre katër viteve nga bangat e shkollave do të dalin rreth tetëdhjet mij nxënës me diploma të shkollave të mesme dhe rreth dyzet mij me diploma të



shkollave të larta e fakulteteve del se problemi i papunësisë do të ashpërsohet edhe, më shumë.

Problemi i papunësisë është një ndër problemet më të rënda në Kosovë. Siç shifet ky problem do të vjen duke u ashpërsuar e jo duke u zgjidhur. Kjo do të ndikon në ashpërsimin e situatës edhe ashtu të acaruar politike. Si rezultat i shtypjes së egër kombtare eksploatimit kapitalistë dhe gjendjes gjithnjë e më të rëndë ekonomike kanë pasuar demonstrata të shumta të cilat po shuhet në gjak. Të rinjtë

e Kosovës kërkojnë punë kushte më të mira jetsore, drejtsi dhe barzi kombtare dhe janë të bindur se një gjë e tillë do të arrihej me konstituimin e Republikës së Kosovës me q' rastë do të shpëputeshin prangat e robërisë të shtypjes dhe të shfrytëzimit dhe atëherë Kosova e pavarur në suaza të Federatës do të kishte mundësi të prodhonte, punësonte e planifikonte vet. Sot si koloni e Seribis një mundësi të tillë nuk e ka.

Bujqësia po përjeton degradizim dhe është lënë kr-

ejt pas dore. Po ti kushtojë kujdesë asaj jo vetëm që do të ishte zgjedhur problemi i punësimit por do të kishte nevojë për punëtorë edhe nga jashtë. Kosova është një vendë i përshtatshëm për veprimtari të shumta ekonomike por ato nuk shfrytëzohen. Përkundrazi edhe ato ndërmarrje të pakta që janë nuk e shfrytëzojnë tërë kapacitetin e tyre e ndodhë edhe të falimentojnë ndërsa punonjësit të mbeten rrugëve si në shtetet kapitaliste.

Pse demonstrojnë të rinjtë e Kosovës quhen pleh nga funksionarët e lartë të qeverisë kuislinge të Kosovës, por le të dalë kjo "mazë" e tradhëtisë së Kosovës dhe le ti zgjedhë këto probleme e pastaj le të shoh se a do të ketë protesta e demonstrata për papunësi e të tjera. Por përderisa të ketë shtypje të egër kombtare, shfrytëzim klasorë, diskriminim nacional, papunësi, varfëri e mjerim grevat dhe demonstratat zdo të pushojnë kurr. Rinija e Kosovës do ta ngrej gjer në qiell zërin e protestës, do të kërkojë punë, drejtësi e liri. Ajo është e reja e ardhmja dhe ajo do të fitojë, do të fitojë se është lum i rrëmbyeshëm që shkatrronë q' do gjë që pengon rrugën e saj të drejtë, ajo ka pararojën e saj, është me klasën punëtorë

masakrime dhe denimet nuk qetsojnë gjendjen

Përkundër të gjitha masave të dhunës dhe terrorit që i kanë ndërmarrë Sigurimi Shtetëror i Jugosllavisë (udb-eja); për të qetësuar situatën e rëndë politike në Kosovë, nuk ka ndonjë përmirsim. Dënimet dhe arrestimet janë bërë refren i përhershëm i ditëve kosovare.

Siç bëhet e ditur vetëtëm kohëve të fundit në Gjilan janë arrestuar më se njëzet punëtorë në mesin e të cilëve të shumtit janë punëtorë të punësuar në botën e jashtme. Këta

të fundit arrestohen e denohen vetëm pse kanë marrë pjesë në demonstratat solidarizuese me ato të vëllezërve të tyre në Kosovë. Shumë prej tyre janë mbetur pa pasaporte ngase UDB-eja si denim ua merr ato për t'i lënë punëtorët dhe familjet e tyre në rrugë pa kurfar të ardhurash e disa prej tyre edhe i denon me burgime të rënda. Fushata e arrestimeve është e pranishme edhe në Kaçanik. U burgosën tre persona nga fshati Stagovë, nje-

ri nga të cilët quhet Fadil Bedriu.

Arrestime kohëve të fundit ka patur edhe në Lipjan, Prishtinë dhe në qendra të tjera të Kosovës. Në Prishtinë janë arrestuar gjashtë nxënës të shkollave të mesme, për të cilët UDB-eja dyshon se kanë marrë pjesë në shkruarjen e parllave, ndërsa në Komunën e Vitisë janë arrestuar tre profesorë.

UDB-eja në pamundësi që ti zbulojë aktorët e vërtetë të

shkruarjes së parollave, gjë që është e pamundur të zbulohet një veprim të cilin e bëjnë dhe e përkrah i tërë populli, po arrestohet numër i madh i njerëzve të pafajshëm të cilët po dënohen pa as më të voglin fakt.

Por përkundër dhunës e terrorit, përkundër dënimeve të egra, shkruarja dhe shpërndarja e afisheve dhe parollave s'ka pushuar asnjëherë. Siç bëhet e ditur, minimumi i parollave të shkruara në ditë arrinë 30 copë. Parollat shkruhen vazhdimisht: në rrugë, në shkollë, ndërmmarrje, fabrika ndërsa aktorët gjithnjë e më rrallë zbulohen gjë që faktin unitetin e popullit dhe demanton gënjeshtret e UDB-es për gjoja numrin e madh të bashkpunëtorëve të sajë në popull.

Parolla të shkruara vërehen më së shumti në kryeqendrën e Kosovës por edhe në qytete të tjera të krahinës, por sidomos në Gjilan edhe



ate në regjionin e Moravës Jugore në fshatrat Remnik, Smirë, Beguncë, Lubishtë, Sllatinë e vende të tjera të këtijregjioni. Parollat e shkruara kan jehonë të madhe ndër masat e gjëra popullore andaj dhe organet e Sigurimit Shtetërorë, UDB-eja, po mendo-

et ti mbanë të fshehura duke qëndruar me brusha ndër duar për ti fshirë posa të vërehën.

Si duket pushteti Jugosllavë akoma nuk e ka kuptuar mirë se gjendja në Kosovë nuk qetsohet, duke denuar, torturuar e arrestuar.

mbrojtja e popullit në kushte lufte

KLasa punëtore është një ndër subjektet e rëndësishëm, për mbrojtjen e popullit dhe të atdheut në kushte të luftës së armatosur.

Është e njohur se qëllimi i ç' do agresioni të armatosur, është pushtimi i vendit tjetër për të zgjëruar forcë ekonomike dhe begatitë e shtetit agresor. D.m.th. se asnjë agresor nuk ka për qëllim të vetëm që të nënshtrojë një popull politikisht dhe ushtarakisht për shkaqe të tjera, pos për ta shfrytëzuar e plaçkitur ekonomikisht. Kët qëll-

im e patën dhe e kan edhe sunduesit e sotëm serb, maqedon, e malazez. Duke u nisur nga ky faktorë, ç' do agresor synon që së pari të then rezistencën e klasës punëtore, ta nënshtrojnë ate dhe ta deytrojnë që të prodhojë për interesat e sunduesve. Vetvetiu ky fakt flutet se klasa punëtore si në prodhimin bujqësorë si në ate industrial i është nënshtroar një presioni të dyfishtë; shfrytëzimit klasorë dhe shtypjes nacionale. Armiku orvatet që nga gjiri i popullit të cilin e ka nën sundimin e vet, të rekrutoi edhe armatë për ta përdorur ate në luftën ekspansioniste për pushtime të vendeve të tjera. Në kët kontekst agresori orvatet që edhe klasën punëtore ta bëjë pjesë të forcave të veta agresive dhe për këtë qëllim përdorë makinerin e fuqishme të propagandës demagogjike. Shembull konkret kemi edhe gjat periudhës së LDB, kur Kosovës iu premtua që pas mbarimit të LDB do të jetë e lirë të vendosë fatet e veta nëse merrë pjesë në luftën kundër okupatorve nazo-fashist, dhe kjo

gënjeshtër u sheshua si demagogji, menjëher pas mbarimit të LDB. Shembull tjetër i freksitet është edhe qëndrimi i hapët demagogjik i armikut dhe shërbëtorëve të tij pas ngjarjeve të përgjakshme të prsnverës së vitit 1981 në Kosovë, kur klasa punëtore shtroi kërkesën për realizimin e barazisë së plotë të Kosovës në RSSH në kuadër të RSFJ, e si përgjegjje e së cilës erdhi një agresion i armatosur nga ana e sunduesve serbomdhenjë.

Kjo situatë e freskët na e bëri me dije se armiku ka mbetur armik, përkundër demagogjisë të përdorur vite me radhë, për gjoja thellimin e barazisë dhe "vëllazërim-bashkimit në federatën Jugosllave. Kjo na dha edhe mësim të vlefshme për qeshtjet e mbrojtjes të popullit në kushte të agresionit nga brenda RSFJ dhe nga jashtë RSFJ. Tri ditët e muajit Prill 1981, vërtetuanë se asnjë armik, sado që i fortë të jetë ai, gjoks me gjoks nuk do t'mund t'ia arrijë që agresionin e vet ta përfundojë me sukses, sepse populli



Shqiptar në mbrojtje të atdhut të vet kurdoherë qe kockë e cila i mbeti në fyt ç' do kujt që provoi ta shkelë me thundrën e ushtarit kët trull. Prandaj armiku u detyrua dhe do të deytrohet edhe në të ardhmen që ndaj Kosovës të përdorë më tepër fuqin ajrore (aviacionin) e altilerinë-bombardimet ngalartë dhe nga largë, dhe mjete të tjera teknike e helmuese, për të shtypur rezistencën e fuqishme të popullit. Jemi dëshmitarë se ndaj Kosovës u përdor aviacioni ushtarak dhe altileria tankiste-toksore më 1981. Gjithashtu gazërat helmues dhe njësit e blinduara, qenë mjete të cilat i përdorën bandat teroriste rankoviqiste në uniformat e ushtrisë, dhe policisë jugosllave, ngase në betejat e përgjakshme gjoks me gjoks, pësuan disfatë të turpshme. Kjo do të thotë se ç' do agresion që do të përsëritete në Kosovë, do të përsëritet edhe kjo formë e luftës ndaj popullit të Kosovës, andaj populli i Kosovës duhet të mendojë dhe të veprojë se si duhet mbrojtur nga agresioni i tillë eventual që ka për qëllim zhdukjen fizike dhe se si do të organizojë betejat për çlirim të vet nga këto llojë sulmesh invazioniste.

Me rëndësi të veçantë është porapregaditje për mbrojtje nga agresionet të cilave u paraprijnë bombardimet ajrore, toksore dhe me helmimet kimike të popullsisë së palëvizshme; fëmijëve, pleqve, grave dhe asaj pjese të popullsisë e cila edhe në kushte lufte duhet ta vazhdojë punën në prodhimin e gjërave elementare: ushqimit dhe mjeteve të tjera të nevojshme jetsore si dhe prodhimeve për nevojat e rezistencës.

Kështu detyrë numër një e ç' do familjeje shqiptare në Kosovë është që të ndërton strehimoret e sigurta e të paisura mirë për strehimin pjeshtarve të familjes së vet, të cilët nuk marrin pjesë në rezistencën aktive, me rastin e këtij lloj agresioni.

Strehimoret duhet të jenë të siguruar që të mos shemben as në kushte të përdorjes së armëve më të rënda të armikut, ato duhet të kenë sistemin ajrorë të filtruar që në strehimore të mos depërtojnë as gazërat helmuese. Në strehimore duhet të ketë dalje të dyfishta, rezerva uji, ushqimi e ngrohje për shumditë javë e muaj. Duhet të ketë edhe mjete ndriqimi: gaz, qirinjë apo okumulatorë, duhet të ketë vendalje të tymit apo ajrit të papastër dhe tualet.

Në strehimore duhet të ketë rroba të mjaftueshme për mbrojtje nga të ftohtit. Vend të mjaftueshëm për të gjithë ata që strehohen. Duhet të ketë mjete sanitare për shërimin e smundjeve, apo plagëve. Duhet të ketë armë me të cilat do të mbrohet familja, në rast të depërtimit të armikut në strehimore. Të gjitha këto duhet të pregaditen sa më parë nga ç' do familje.

VAZHDON NË NUMRIN E ARDHSHËM

NË SULMET E ZJARRTA PUNËTORËT PËRPARA

Në sulmet e zjarra punëtorët përpara shkojnë në luftë dhe Partia jonë është proletarja Flamuri i saj na prin ne.

Shpirtërat e heronjëve dhe në Gjallë jemi e kurr s'hem me vdekkë

Partia proletare na prin para dhe në luftojmë për botën e re

Le të shkelin mbi trupat tonë Tankset e armikut, autobлиндat le t'na sulmojnë

Ne nuk z'brapsemis friksohemi E drejta është në anën tonë dhe ne do të fitojmë.

Me sy shqiponje përball armikut Flamurin e kuq lartë e kemi ngritë

Me rinin tonë zemër qeliku Marsojmë drejt Kosovës- Republikë.

UDB- A E PAFUQISHME PARA ORGANIZIMIT TË MIRFILLËT TË KLASËS PUNËTORE

Që nga viti 1975, kur Partia veprimi në organizimin e mirfilltë të Lëvizjes për pavarësinë (republikën) e Kosovës, udhëheqësisë së LKJ dhe qeverisë jugosllave në mënyrë

të vazhdueshme iu shtrua kërkesa e klasës punëtoare dhe e popullit të Kosovës për realizimin e të drejtave kushtetutare në themelimin e RSSH në



në Jugosllavi, UDB-a serbe i filloi gjurmimet e veta, për të zbuluar qendrat kryesore të organizimit të Partisë e sidomos KQ të saj.

Veprimi i hapët i Partisë, ishte një mënyrë e pashembull për UDB-en jugosllave. Partia organizoi aksione të shumta legale që nga shkollat fillore e deri te udhëheqësit më të larta të Kosovës dhe të RSFJ. Dy forma kryesore të veprimit ishin karakteristike në aktivitet; njera shtronte në mënyrë ligjore dhe të hapët kërkesën për republikë para autoriteteve jugosllave; ndërsa tjetra e afirmonte këtë kërkesë drejtpërdrejtë në masë në mënyra shumë të rëndomta...

Interesi i UDB-es as nuk nisej e as nuk përfundonte në zyrat e tyre të errëta. KQ i LKJ informohej vazhdimisht edhe për hetimet e UDB-es, mirëpo vetëm në pjesën e Serbisë. Eshtë me rëndësi të theksohet se hetimet e hapta filluan 5 vite më vonë, në Qershor të vitit 1980, kur rankoviqizmi filloi të rikthehet në pushtet.

Baza ligjrore për t'u dënuar kërkesa për republikë nuk kishte, andaj e tërë puna për qëndrohej në pamundësimin e organizimit të kësaj kërkesë, në masa. Për këtë në Kosovë u caktua ish polici-Xhevdet Hamza. Mirëpo, të tëra orvatjet e tyre ishin të kota.

Në Dhjetorë 1980, Partia e vlerësoi situatën realisht dhe erdhi në përfundim që gjatë vitit 1981 duhet të dilet me kërkesën për republikë në mënyrë demonstrative. Më dhjetorë 1980 në KQ të Partisë u dha urdhëri që të themelohet Shtabi Organizativ i demonstratave. Ky shtab fillojë të funksionojë qysh në Janarin e vitit 1981 dhe zbatoi e po vazhdon të zbaton edhe sot e kësaj dite detyrat e veta.

E tërë UDB-a jugosllave u ngrit të zbuloi Komitetin Qendror të Partisë dhe SHTABIN ORGANIZATIV, mirëpo hetimet, marshuan në vend. Ky rezultat

pozitiv u arrit në saje, edhe të konspiracionit, edhe të organizimit të tërthortë territorial, gjë që pamundësoj dëmtimin e forcave kryesore, edhe pse ato pjesërisht u goditën.

Këtë shembull e dhamë për të ilustruar dhe për të arsyetuar nevojën e një organizimi të themeltë dhe të qetë.

Do të shohim se aktiviteti dhe e tërë lufta politike që zhvilloi në Kosovë Partia, u zhillua pikërisht me atë diktat dhe në ato forma, të cilat armikut nuk i përgjigjen. Në anën tjetër platforma e Partisë, mbi kërkesën e republikës u shëndrrua në një lëvi-

stilit alla-fashist, masakruan një pjesë të madhe të popullsisë së Kosovës së tërsishme, mirëpo Lëvizjen nuk pat e nuk ka fuqi që e ndalë. Partia i dha shpresën e fortë klasës punëtore dhe popullit të Kosovës se, kosovarët duke u mbështetur në forcat e veta mund t'i dalin zot Kosovës.

Para neve punëtorëve, populli dhe atdheu venë detyrë konkrete që të organizohemi sa më mirë dhe sa më fortë në Bashkimin e Punëtorëve të Kosovës dhe të qëndrojmë në ballë të frontit në luftën politike për realizimin e të drejtave në pavarësi dhe barazi-në Republikën S.SH. të Kosovës.



UDB-ES PO I DIGJET TOKA NËN KËMBË NË KOSOVË

zje të përgjithshme popullore e cila kurorën e organizimit, të nivelit të lartë e arriti në themelimin e LRSSHJ (Lëvizjen për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi)ku erdhi deri te bashkimi i rrymave të mëparshme politike në këtë lëvizje të vetme. Armikut (rankoviqizmit) nuk i mbeti tjetër, pos përdorja e dhunës dhe terrorit, duke shkelur kushtetutën dhe ligjet tjera normative të RSFJ, me shpresë se ndoshta në këtë mënyrë mund ta fiton betejën kundër kërkesës për republikë. Terorri-genocidi, persekutimet dhe proceset e montuara gjyqësore të

Në këtë aspekt, edhe pse e dijmë se në radhët e popullit tonë, UDB-a ka më pak spiunë të vet se sa kurdoherë në histori, ne duhet t'i përmbahemi rregullave të konspiracionit, të organizimit dhe të zbatimit të detyrave me konsekuencë, duke patur bindjen se nga ç'do njeri prej nesh mvarret fitorja. Dhe, atë do ta arrijmë patjetër nëse ç'donjeri nga ne kryen detyrat dhe obligimet që ka ndaj vetvehtes si person, ndaj popullit e ndaj atdheut.

VAZHDON NE NUMRIN E ARDHSHEM